



REPUBLIKA E SHqipëRIE  
MINISTRIA E BRENDSHME

# **Raporti i Monitorimit Vjetor 2020**

## **Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore**

**Gusht 2021**

Raporti i monitorimit 2020 të Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore u përgatit nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore), me asistencën e projektit STAR 3.

## Përmbajtja

1. Hyrje.....	7
2. Informacion përmbledhës mbi SKNDQV .....	8
3. Metodologjia .....	11
4. Progresi Strategjik .....	12
4.1. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik A .....	13
4.2. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik B: .....	27
4.3. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik C: .....	32
4.4. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik D .....	46
5. Vlerësimi i riskut.....	54
6. Konkluzione dhe Rekomandime .....	56
7. Aneks .....	58

## Lista e Tabelave

<b>Tabela 1:</b> Lista e PDV-ve të Miratuara për vitin 2020 / e-Planifikimi .....	15
<b>Tabela 2:</b> Vendime të Këshillit të Ministrave.....	44
<b>Tabela 3:</b> Realizimi i Nënobjektivit/Aktiviteti për Objektivin Specifik D .....	53

## Lista e Figurave

<b>Figura 1:</b> Struktura e Ministrisë së Brendshme lidhur me çështjet vendore.....	17
<b>Figura 2:</b> Struktura e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore .....	17

## Lista e Grafikëve

<b>Grafiku 1:</b> Raportimi për Planin e Veprimit .....	13
<b>Grafiku 2:</b> Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik A.....	13
<b>Grafiku 3:</b> Vlerësimi i Indikatorëve për Objektivin Specifik A për vitin 2020 .....	14
<b>Grafiku 4:</b> Projekt akte në KK gjatë vitit 2020.....	24
<b>Grafiku 5:</b> Projekt akte në KK gjatë vitit 2020 të urdhrit të Kryeministrit .....	25
<b>Grafiku 6:</b> Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik B.....	27
<b>Grafiku 7:</b> Vlerësimi i Indikatorëve për Objektivin Specifik B për vitin 2020.....	28
<b>Grafiku 8:</b> Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik C.....	32
<b>Grafiku 9:</b> Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik D.....	46
<b>Grafiku 10:</b> Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.1 .....	47
<b>Grafiku 11:</b> Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.2 .....	48
<b>Grafiku 12:</b> Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.4 (masat a dhe b) .....	49
<b>Grafiku 13:</b> Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.4 (masa c).....	50
<b>Grafiku 14:</b> Niveli i riskut sipas masave për secilin nën-objektiv të objektivit A .....	55
<b>Grafiku 15:</b> Niveli i riskut sipas masave për secilin nën-objektiv të objektivit B .....	55
<b>Grafiku 16:</b> Niveli i riskut sipas masave për secilin nën-objektiv të objektivit C .....	56

## **Shkurtime**

ADISA – Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara  
AFMIS – Albanian Financial Management Information System  
AK – Anti-Korrupsion  
AKM – Agjencia Kombëtare e Mjedisit  
AKP – Agjencia Kombëtare e Pyjeve  
AKPT – Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit  
AKSHI – Agjencia Kombëtare Shqiptare e Informacionit  
AMBU – Agjencia Menaxhimit të Burimeve Ujore  
AMVV – Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore  
ANT – Analiza e Nevojave për Trajnim  
ASPA – Shkolla Shqiptare e Administratës Publike  
ASHK – Agjencia Shtetërore e Kadastrës  
AZHT – Agjencia e Zhvillimit të Territorit  
BE – Bashkimi Evropian  
DAP – Departamenti Administratës Publike  
DPD – Drejtoria e Përgjithshme e Doganave  
DPT – Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve  
ERRU – Enti Rregullator i Ujit  
FSHZH – Fondi Shqiptar i Zhvillimit  
IPA – Instrument for Pre-Accession Assistance  
KK – Këshilli Konsultativ  
KM – Këshilli i Ministrave  
KMSHC – Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil  
MASR – Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë  
MB – Ministria e Brendshme  
MBZHR – Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural  
MD – Ministria e Drejtësisë  
MEPJ – Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme  
MFE – Ministria e Financave dhe Ekonomisë  
MIE – Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë  
MK – Ministria e Kulturës  
ML – Ministrinë e Linjës  
MSHMS – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
MTM – Ministria e Turizmit dhe Mjedisit  
MZSH – Mbrojtje nga Zjarri dhe Shpëtimi

NJVV – Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

PBA – Plani i Buxhetit Afatmesëm

PV – Plani i Veprimit

RAT – Reformës Administrative Territoriale

RKGJC – Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile

SNDQV – Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore

SHQSH – Shoqata e Qarqeve të Shqipërisë

UK – Ujësjellës Kanalizime



## 1. Hyrje

Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (SKNDQV) u miratua në vitin 2015, duke përcaktuar objektivat e procesit të decentralizimit në Shqipëri. Para kalimit të çështjeve vendore si një fushë e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme, Qeveria Shqiptare, në asistencën e partnerëve të zhvillimit, ndërmoi 2 monitorime vjetore, më konkretisht në vitin 2016 dhe 2017. Më pas, si domosdoshmëri e një vlerësimi më të detajuar dhe kumulativ të masave të zbatuara në kuadër të SKNDQV 2015-2020, u ndërmoi Rishikimi Afatmesëm i Strategjisë, i cili theksoi rëndësinë e objektivave të SKNDQV për nevojat e qeverisjes vendore, ndërsa vetë procesi i decentralizimit do të përfitonte nga një përditësim i Planit të Veprimit të strategjisë. Kësisoj, ndjekur nga një proces shumë të gjatë konsultimi në kohë me shumë aktorë, Plani i Veprimit i SKNDQV u rishikua dhe përditësua deri në 2022 me anë të Vendimit nr. 783, datë 07.10.2020, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të veprimit 2020–2022, në zbatim të Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020”.

Kësisoj, në kuadër të raportimeve vjetore të Planit të Veprimit, raporti i monitorimit të vitit 2020 synon të japë në mënyrë të përmbledhur ecurinë e zbatimit të objektivave, nënobjektivave, aktiviteteve dhe masave të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore. Duke qenë një strategji ndërsektorale, hartimi i raportit të monitorimit ka shënuar një proces kompleks koordinimi me shumë institucione si Ministrinë e Linjës, Agjencitë Qendrore, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe shoqatat vendore. Gjithashtu, në kuadër të hartëzimit të donatorëve në fushën e vetëqeverisjes vendore, MB/AMVV është në proces të përditësimit të mbështetjes donatorë sipas Planit të Veprimit dhe mbulimit gjeografik.

Procesi i hartimit të raportit të monitorimit ka qenë një proces i asistuar nga projekti STAR 3, në të cilën Qeveria Shqiptare është bashkëfinancuese, së bashku me partnerët e zhvillimit Delegacioni i Bashkimit Evropian, Ambasada Suedeze, Ambasada Zvicerane dhe UNDP. Ky proces, ndryshe nga raportet e kaluara të monitorimit, është fokusuar në rritjen e kapaciteteve dhe trajnimin e dy strukturave përgjegjëse për monitorimin e Strategjisë Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore dhe Planit të tij të Veprimit. Për këtë arsye, u krijua një grup pune nga Drejtoria e Çështjeve Vendore dhe Agjencisë për Mbështetje të Vetëqeverisjes Vendore. Sikurse përmendur më sipër, për herë të parë, raporti i monitorimit është hartuar nga stafi i MB/AMVV, asistuar nga projekti STAR 3.

Gjithsesi, në kuadër të raportit të monitorimit duhen theksuar edhe problematikat e hasura lidhur me marrjen e informacionit nga institucionet përgjegjëse dhe hartimit të raportit SKNDQV. Duke qenë një strategji ndërsektorale, procesi ka qenë kompleks dhe shpeshherë më vonesa nga ana e institucioneve raportuese. Përtej vonesave në raportim, dy problematika të përgjithshme në realizimin e objektivave të planit të veprimit të SKNDQV janë edhe situata post-tërmet dhe pandemia. Situata post-tërmet duket se ka pasur efektet e saj, veçanërisht në pushtetin vendor, edhe në fillimet e vitit 2020. Ndërsa, efektet e kësaj situatë janë amplifikuar edhe nga pandemia, e cila dha efektet gjatë gjithë vitit 2020, vit për të cilën bëhet monitorimi i planit të veprimit. Kësisoj, veçanërisht situata e COVID-19 pritet të ketë efekt në arritjen e rezultateve të parashikuara në planin e veprimit, sikurse shumë të dukshme janë efektet në financat vendore.

Në mënyrë të përmbledhur ky raport jep një përmbledhje të shkurtër mbi SKNDQV, përditësimin dhe rishikimin e planit, ashtu edhe harmonizimin ligjor për funksionet e deleguara, si prioritet në agjendën e decentralizimit. Së dyti, raporti shpjegon metodologjinë e ndjekur për marrjen e informacioni dhe

hartimin e raportit. Së treti, raporti shpjegon progresin në nivel objektiv, nënobjektiv, aktiviteti dhe mase të planit të veprimit të SKNDQV. Së fundi, raporti mundohet të vlerësojë riskun e realizimit të objektivave. Në fund, raporti konkludon me disa përfundime dhe rekomandime kryesore.

## 2. Informacion përmbledhës mbi SKNDQV

### a) Përditësimi dhe Rishikimi i Planit të Veprimit, 2020-2022

Nisur nga dy raportet vjetore të monitorimit, të vitit 2016 dhe 2017, theksohej nevoja e një rishikimi më të detajuar veçanërisht të funksioneve specifike të transferuara tek pushteti vendor nga ai qendror. Gjithashtu, vërehet se dy monitorimet nuk vlerësojnë në mënyrë progresive shkallën e zbatimit të Planit të Veprimit të SKNDQV, duke e bërë të vështirë një vlerësim koherent të ecurisë së strategjisë.

Në këtë kuadër, Ministria e Brendshme zhvilloi Rishikimin Afat-Mesëm (RAM) të strategjisë, duke vlerësuar zbatimin e tij për tre vitet e para të SKNDQV. Rishikimi kishte si qëllim të informojë autoritetet shqiptare përgjegjëse mbi progresin e arritur, të identifikojë pengesat në zbatim dhe të nxjerrë mësim për të ripërcaktuar dhe optimizuar veprimet dhe ndërhyrjet për arritjen e objektivave dhe rezultateve të strategjisë. Ky studim u zhvillua gjatë tremujorit të tretë të 2018, duke përfshirë periudhën 2015-2018.

Në përgjithësi, RAM arrin në përfundimin se SKNDQV mbetet koherente dhe e vlefshme për nevojat e shumë aktorëve si qeverisë vendore, qeverisë qendrore dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në çështjet e pushtetit vendor. RAM, më tej, thekson se *"Nuk është e nevojshme të rishikohet vetë SKNDQV, por procesi i decentralizimit do të përfitonte nga një përditësim i Planit të Veprimit të strategjisë, i shoqëruar me një prioritet të veprimeve që duhen ndërmarrë. Plani i ri i veprimit duhet të shoqërohet me një analizë të kostos, për të garantuar procesin e zbatimit"*.

Sa më sipër, është konfirmuar shtyrjen e afatit të SKNDQV deri në vitin 2022. Kësisoj, është vazhduar me përditësimin dhe rishikimin e Planit të Veprimit të strategjisë. Objektivi kryesor është të avancojë procesin e decentralizimit dhe të forcojë qeverisjen vendore duke përgatitur një Plan Veprimi të rishikuar dhe të përditësuar për periudhën deri në vitin 2022.

Për rishikimin dhe përditësimin e Planit të Veprimit të SKNDQV janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Përdorimi i Urdhrit të Ministrisë nr.147 datë 14.02.2019 "Për ngritjen e sekretariatit teknik, në kuadër të funksionimit të Grupit Tematik të Decentralizimit (GTD), në zbatim të Urdhrit Nr. 157, datë 22.10.2018", për të filluar punën mbi përditësimin dhe rishikimin e Planit të Veprimit; Grupi i punës udhëhiqet nga Zëvendësministri i Brendshëm përgjegjës për koordinimin me pushtetin vendor;
- Konsultimi me grupin teknik të ekspertëve në çdo ministri të linjës, sipas përfaqësuesve të institucioneve në Grupin Tematik të Decentralizimit;

Procesi i përditësimit dhe rishikimit të Planit të Veprimit përfshiu (i) shqyrtimin e dokumenteve të identifikuar dhe përgatitjen e planit operativ për rishikimin e planit të veprimit, (ii) konsultime me ekspertë teknik në nivel ministrie linje dhe aktorësh të tjerë (bazuar në shkresat e dërguara nga institucionet mbi përfaqësuesit e tyre në grupin tematik të decentralizimit) për të rishikuar planin e



veprimet respektiv, (iii) përgatitja e draftit të parë të Planit të Veprimit dhe (iv) konsultime dhe validim gjetjesh mbi Planin e Veprimit të rishikuar dhe të përditësuar.

Sa më sipër, Plani i Veprimit i SKNDQV vlerësohet të jetë një *ndër planet më të konsultuara me të gjithë aktorët në fushën e decentralizimit*. Konsultimi ishte gjithëpërfshirës dhe përfshiu Ministrinë e Linjës, Agjencitë Shtetërore, Partnerët e Zhvillimit/Donatorët, Shoqatat e Bashkive, disa bashki të përzgjedhura dhe palët e tjera të interesuara.

Gjithashtu, dy Grupe Tematike të Decentralizimit u organizuan nga Ministria e Brendshme duke përfshirë anëtarët e këtij grupi në të gjitha fazat e hartimit të këtij plani të veprimit. Të gjitha komentet dhe sugjerimet janë adresuar në përputhje me rrethanat në draftin ekzistues të planit. Paralelisht, një konsultim i gjerë online dhe takime intensive me Ministrinë e Linjës ndihmuan në përcaktimin më të mirë të objektivave të Planit të Veprimit.

Plani i Veprimit i rishikuar mori parasysh të gjitha mendimet e aktorëve të sipërpërmendur duke rezultuar në katër objektiva kryesore strategjik, si më poshtë:

- A. Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- B. Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale;
- C. Promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm vendor;
- D. Forcimi i qeverisjes së mirë në nivelin vendor.

Objektivi i parë strategjik përfshin tre objektiva specifike: (i) konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative; (ii) aplikimi i shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë e informacionit për 61 bashki dhe njësi të tyre administrative; (iii) forcimi i dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme.

Objektivi i dytë përfshin pesë objektiva specifike, siç janë (i) konsolidimi i sistemit të të ardhurave të veta vendore dhe administrimit fiskal vendor; (ii) rritja e ndarjes së të ardhurave nga taksat kombëtare me bashkitë; (iii) përmirësimi i parashikueshmërisë, stabilitetit dhe përshtatshmërisë së sistemit të transfertave qeveritare; (iv) rritja e kapaciteteve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) për të përdorur huamarrjen për financimin e projekteve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik; (v) forcimi i sistemit të menaxhimit të financave publike në nivelin vendor.

Objektivi i tretë përfshin tre objektiva specifike: (i) zbatimin efikas i funksioneve të veta bazuar në një kuadër ligjor të qartë dhe të harmonizuar; (ii) sigurimi i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik vendor; (iii) ngritja dhe përditësimi i standardeve minimale kombëtare për shërbimet vendore.

Objektivi i katërt dhe i fundit përfshin katër objektiva specifike: (i) sigurimin e qeverisjes së hapur, rritjen e transparencës, përgjegjshmërinë dhe shtrirje më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor; (ii) Integrimi Evropian dhe qeveria vendore; (iii) forcimi i strukturave komunitare në nivel vendor (Komisionet qytetare, Kryetarët e fshatrave, Ndërlidhësit qytetarë); (iv) adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore.

Duke pasur parasysh se të gjitha objektivat, përkatësisht A, B, C dhe D, ofrojnë asistencë teknike, mbështetje për njësitë e vetëqeverisjes vendore, studime, përmbledhje ligjore dhe teknike të funksioneve të deleguara për pushtetin vendor, plani i veprimit shoqërohet me kosto indikative sipas artikujve përkatës, të cilat bazohen gjithashtu në Programin e Buxhetit Afatmesëm. Sipas rasteve specifike, burimi i financimit përbëhet nga buxheti i shtetit dhe mbështetja e donatorëve (financimi i

huaj). Synimi për të pasqyruar sa më të detajuar mbulimin buxhetor ka bërë të mundur që të përcaktohen edhe ato masa të cilat janë pjesërisht ose totalisht të pa mbuluara me buxhet. Ky informacion bën të mundur një vlerësim të boshllëkut financiar për të cilin duhet që të merren masa për mbulim nga buxheti i shtetit ose donatorët. *Në mënyrë të përmbledhur, Plani i rishikuar i veprimtad adreson disa nga çështjet më kryesore të pushtetit vendor si më poshtë:*

1. Ngritja e Zyrave me Një Ndalesë në Njësitë Administrative;
2. Rritja e kapaciteteve institucionale të bashkive me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike;
3. Forcimi i dialogut mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore;
4. Krijimi i sistemit të standardizuar dhe formalizuar të të dhënave vendore për një vendimmarrje të informuar;
5. Zbatimi i ndarjes së të ardhurave nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP), rritja e rentës minerare nga 5% në 8%;
6. Rimëkëmbje financiare e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimi i ujërave të ndotura; Menaxhimi i burimeve ujore dhe siguria e digave; Forcimi i kompetencave rregullatorë dhe administrative të bashkive në fushën e mbrojtjes së mjedisit, shërbimeve sociale, arsim parashkollor, bujqësi, zhvillim rural, pyje dhe kullota;
7. Harmonizimi i bazës ligjore me akte nënligjorë nga ana e Ministrive të Linjës sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore për funksionet e deleguara NJVV;
8. Hartimi dhe/ose përditësimi i standardeve minimale kombëtare për fushat prioritare si: Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi, Arsimi parauniversitar, shërbimet e pastrimit, gjelbërimit; strehimi; Siguria (policia bashkiake); bujqësia dhe zhvillimi rural dhe emergjencat civile.
9. Forcimi i kapaciteteve të NJVV-së në kuadrin e projekteve të financuara nga fondet e BE-së;
10. Hartimi i Planeve të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në të gjitha bashkitë.
11. Përfshirja e aspekteve të demokracisë vendore me fokus të veçantë në barazinë gjinore.
12. Intesifikimi i iniciativave inovative të cilat synojnë rritje të performancës së bashkive, siç janë praktikatat e mira.

Plani i Veprimtad hyri në fuqi në tetor 2020, sipas Vendimit nr. 783 , datë 07.10.2020 të Këshillit të Ministrave dhe ka një shtrirje kohore deri në fund të vitit 2022.

#### **b) Harmonizimi ligjor**

Transferimi i kompetencave nga pushteti qendror në atë vendor në vitin 2015 nuk ka qenë krejtësisht i qartë dhe ende pasqyron mbivendosje ose boshllëqe në zbatimin e tyre. Raporti i dytë i monitorimit të SNDQV 2015-2020 dhe Vlerësimi Afatmesëm i SNDQV 2015-2020 identifikojnë një sërë pengesash ligjore dhe institucionale në ekzekutimin sa më efektiv të funksioneve, gjë që kërkonte ndërhyrje të mëtejshme.

Sa më sipër, me mbështetjen e Delegacionit Evropian në Shqipëri, një proces i udhëhequr nga Ministria e Brendshme/AMVV, është ndërmarrë një studim "Matrica e Kompetencave", në identifikimin konkret të hapësirave ligjore dhe përplasjeve të ligjit organik 139/2015 (Për Vetëqeverisjen Vendore" me ligje të tjera sektoriale për funksionet e pushtetit vendor. Më

konkretisht, në studim u vu re që Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) hasin një sërë sfidash në terma të: (i) mjaftueshmërisë së burimeve financiare dhe diskrecionin e NJVV-ve në lidhje me shpërndarjen e këtyre burimeve; (ii) përputhshmërinë e ligjit organik të NJVV me ligjet e tjera sektoriale; (iii) pamjaftueshmërinë e burimeve dhe kapaciteteve njerëzore të tyre; (iv) shtrirjen dhe cilësinë e dhënies së shërbimeve publike të qytetarët dhe (v) efektivitetin e ushtrimit të funksioneve të NJVV.

Bazuar në këtë studim, Ministria e Brendshme ka kategorizuar pengesat e identifikuara sipas nivelit të përparësisë së tyre për një periudhë kohore prej 4 vjetësh (2019, 2020, 2021 dhe 2022), shoqëruar me rekomandimet përkatëse. Me referencë të veçantë në grupin e parë të rekomandimeve (viti 2019), MB, duke pasur parasysh rëndësinë e matricës së kompetencave, veçanërisht në drejtim të boshllëqeve dhe mbivendosjeve të identifikuara në lidhje me disa funksione kryesore të njësive të qeverisjes vendore, ka sugjeruar hartimin e Urdhër i Kryeministrit, i cili urdhëron të gjitha ministritë e linjës të angazhohen në rekomandimet e studimit të sipërpërmendur.

Në përputhje me rrethanat, miratohet Urdhri i Kryeministrit, përkatësisht Urdhri i Kryeministrit nr.101, datë 03.07.2019 "Për miratimin e akteve nënligjore nga Ministritë e Linjës, sipas fushës së përgjegjësisë së shtetit, për funksionet e deleguara të Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore". Paketat legjislative për ministritë e linjës i bashkëlidhen Urdhrit të Kryeministrit, duke siguruar një hartë të qartë për secilin Ministri të Linjës për të harmonizuar dhe kompletuar plotësisht kornizën sektoriale ligjore dhe institucionale në lidhje me njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me Ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe në përputhje me SKNDQV.

Ministria e Brendshme po ndjek këtë proces çdo muaj, si institucioni përgjegjës për agjendën e qeverisjes vendore. Statusi i zbatimit të përgjithshëm të këtij urdhri është rreth 90%. Informacioni i raportuar nga Ministritë e Linjës tregon se shumica e Ministrive të Linjës kanë zbatuar rekomandimet, ndërsa ekziston nevoja për ndjekje të mëtejshme për rekomandimet e mbetura. Gjithashtu, duhet të theksohet se MB është në përfundim të paketave të rekomandimeve të vitit 2021.

### **3. Metodologjia**

Raporti i Monitorimit Vjetor - 2020 i SNDQV është mbështetur mbi një analizë të detajuar informacionesh primare dhe sekondare. Metodologjia e përdorur në raport synon të përafrohet sa më tepër me kërkesat e përcaktuara në Vendimin nr. 290, datë 11.4.2020 "Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS) si dhe duke respektuar strukturën e raporteve të monitorimit për dokumentet strategjike sektorial dhe ndërsektorial për agjendën e mirëqeverisjes.

Nisur nga plani i veprimit i SNDQV u përgatitën tabela specifike për secilin institucion që është i përfshirë në aktivitete apo masa në këtë strategji. Pyetëtori ndër të tjera përmban informacion mbi buxhetin e përdorur dhe nivelin e riskut për arritjen e objektivit deri në përfundim të planit të veprimit të SNDQV. Institucionet përgjegjëse të përfshira në këtë strategji janë 14 në nivel qendror, ndërkohë që institucionet kontribuuese janë mbi 40 të tilla. Gjithashtu pjesë janë edhe të gjitha NJVV-të dhe donatorët ndërkohë që kontribuues janë edhe shoqatat e bashkive dhe të qarqeve.

Në vijim të mbledhjes së informacionit u përgatit edhe një dokument për raportimin e indikatorëve të planit të veprimit sipas objektivave specifike i cili specifikon qartazi vlerësimin dhe qëllimin e indikatorit në kuadër të arritjeve deri në përfundim të periudhës së planit të veprimit të strategjisë.

Ky dokument përmban në mënyrë të detajuar mënyrën e llogaritjes së secilit indikator, institucionin përgjegjës si dhe periudhat referuese të vlerësimit të indikatorit.

Procedura e përgatitjes së mbledhjes së informacionit u konsultua paraprakisht me të gjitha strukturat në MB/AMVV që janë të përfshira në monitorimin e pushtetit vendor dhe më pas u shpërnda te të gjithë institucionet e përfshira të cilët u asistuan në mënyrë konsistente mbi të gjitha aktivitetet që lidheshin me to. E njëjta procedurë u ndoq edhe për mbledhjen e informacionit nga NJVV-të, gjë e cila u bë i mundur nëpërmjet përfshirjes së AMVV në këtë proces. Gjithashtu, në disa prej aktiviteteve të Planit të Veprimit kanë raportuar edhe Shoqatat e Bashkive (Shoqata për Autonomi Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë) dhe Shoqata e Qarqeve.

Lidhur me formatet e përdorura, me ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe shoqatat janë përdorur formate Excel, të përgatitur sipas udhëzimeve të dhëna në kuadër të IPSIS, ndërsa raportimi për NJVV është përgatitur në version elektronik (google form) me qëllim lehtësimin e marrjes së informacionit. Për të patur një pamje sa më të qartë të realizimit të strategjisë, analiza u bë në disa nivele të informacionit, duke filluar në nivel objektiv specifik, nën-objektiv, aktiviteti dhe mase. Për secilin rast, mbështetur mbi raportimet e institucioneve, u analizuan të gjitha arritjet gjatë vitit 2020.

Gjithsesi, vlen të theksohet se duke qenë monitorimi i parë sipas disa standardeve të unifikuara të procesit të monitorimit, në aspektin raportues ka patur edhe vështirësi kryesisht në përcaktimin buxhetor dhe të niveleve të riskut të arritjeve për secilën masë.

#### **4. Progresi Strategjik**

Plani i rishikuar i Veprimit 2020 -2022 i SKNDQV, duke u nisur nga konkluzionet e nxjerra nga MTR, ku konkludohet se strategjia mbetet relevante, është i mbështetur mbi të njëjtat objektiva specifik me ato të strategjisë duke i përshtatur dhe specifikuar sipas zhvillimeve më të fundit në çështjet vendore si dhe në konsistencë me objektivat e qeverisë. Ky plan përbëhet nga 4 objektiva specifike të cilët detajohen më tej në nën-objektiva- aktivitete dhe masa, ku secila është e lidhur së paku me një institucion përgjegjës. Katër objektivat specifik të këtij plani veprimi janë:


- OBJEKTIVI SPECIFIK A: Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore
- OBJEKTIVI SPECIFIK B: Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale
- OBJEKTIVI SPECIFIK C: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor
- OBJEKTIVI SPECIFIK D: Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor

Pjesa më e madhe e aktiviteteve dhe masave të këtij plani veprimi janë të shtrira në një periudhë 3 vjeçare (2020-2022), pra gjatë gjithë periudhës që mbulon plani i ri i veprimit. Gjithsesi gjatë vitit 2020 ka patur arritje të prekshme në secilin prej objektivave dhe po ashtu në pjesën më të madhe të aktiviteteve. Plani i veprimit ka në total 15 nën-objektiva dhe 60 aktivitete, ku në nivel nën-objektiv, ministritë e linjës, institucionet qendrore dhe NJVV kanë raportuar në masën 94%, e ndërsa 6% e nën-objektivave nuk janë raportuar.

Duhet theksuar se këtu nuk bëhet fjalë për shkallën e realizimit të një nën-objektiv, por vetëm për shkallën e raportimit. Duke kaluar në nivel aktiviteti, shihet se shkalla e raportimit është në një masë më të vogël, më konkretisht 80%. Ndërsa, duke zbritur në nivel mase, shkalla e raportimit shkon në 74%.

**Grafiku 1: Raportimi për Planin e Veprimit**


Shkalla e raportimit në nivel Nënobjektivi    Shkalla e raportimit në nivel Aktiviteti    Shkalla e raportimit në nivel Mase




**4.1. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik A**

Objektivi specifik “Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore” përbëhet nga 3 nën-objektiva dhe 10 aktivitete. Në këtë objektiv specifik janë të përfshira 7 institucione përgjegjëse për realizimin e komponentëve të tij. Nga raportimi rezulton që në të gjithë nën-objektivat ka patur hapa konkrete në realizimin e tyre, ndërsa në nivel aktiviteteve ka patur rezultate në 8 prej 10 që janë në total dhe në nivel masash ka patur rezultate në 34 nga 45.

**Grafiku 2: Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik A**



Në kuadër të këtij objektiv specifik në SKNDQV janë përcaktuar edhe disa indikatorë matës. Përsa i përket indikatorit A.1 - *Numri i bashkive që ofrojnë shërbime administrative në zyra me një ndalesë*, rezulton që vlera e synuar për vitin 2020 ishte të arrinte në 90% ndërkohë që vlera e realizuar është 96.7%, ndërkohë që deri në vitin 2022 kur përfundon periudha e planit të veprimit të SKNDQV synimi është që të arrij në 100% të bashkive dhe po ashtu edhe në nivel njësie administrative. Indikatorit tjetër i raportuar lidhet me *Numri i bashkive ku sistemi i arkivimit është funksional* ku niveli i synuar për vitin 2020 ishte 25% ose 15 NJVV, por që nuk ka patur asnjë zhvillim në këtë kuadër, ndërkohë që niveli i synuar për vitin 2022 është 45% e NJVV-ve.

**Grafiku 3:** Vlerësimi i Indikatorëve për Objektivin Specifik A për vitin 2020

Pjesë e këtij objektiv strategjik është edhe një indikator i lidhur me “trajnimin e personelit vendor çdo vit në përputhje me vlerësimin e nevojave për trajnim”. Në këtë kuadër gjatë vitit 2020 janë trajnuar 6130 staf i pushtetit vendor nga ASPA ose 19% e totalit të tyre ndërkohë që synimi ishte që të trajnoheshin 20% e stafit në vitin 2020 dhe deri në fund të vitit 2022 të arrij në 45 % të stafit të pushtetit vendor.

Në mënyrë më të detajuar rezultatet për secilin nën-objektiv, aktivitetet dhe masë duke u ndalur në të gjitha rezultatet për secilin paraqiten në vijim.

### **Nën-objektivit A1 “Konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative”**

Përsa i përket nën-objektivit A1 (*Konsolidimi i kapaciteteve të strukturave administrative*), i cili përbëhet nga 4 aktivitete, rezultate konkrete vihen re në:

#### **A1.1 “Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve strategjike”**

**Në kuadër të aktivitetit A1.1, masa a, (Asistencë për harmonizimin dhe zbatimin e Planeve të Zhvillimit të Territorit sipas ndarjes administrative),** referuar të dhënave të dërguar nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në kuadër të konsolidimit të Reformës Administrative Territoriale (RAT) dhe pajisjes së bashkive të reja me instrumentet e nevojshme për qeverisjen e mirë dhe të qëndrueshme të territorit, qeveria shqiptare nëpërmjet ministrisë përgjegjëse për planifikimin e territorit dhe AKPT-së, ka ndërmarë nismën për mbështetjen e pushtetit vendor për mbulimin e të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë me Plane të Përgjithshme Vendor.

Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, në zbatim të kompetencave të saj ligjore si autoriteti përgjegjës për bashkërendimin e procesit të hartimit dhe të rishikimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, të cilat ndërmerren nga autoritetet e planifikimit në nivel qendror e vendor, ka

bashkërenduar dhe asistuar të **61 bashkitë e vendit** në hartimin e dokumenteve të planifikimit të territorit në dy nivele:

1. Plane të Përgjithshme Vendore;
2. Plane të Detajuara Vendore.

Aktualisht 83.6% e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore kanë hartuar Plane të Përgjithshme Vendore (PPV), dokument i cili përcakton kuadrin referues të detyrueshëm për mbrojtjen dhe përdorimin e territorit administrativ të njësisë së qeverisjes vendore (bashkisë). Pjesë integrale e PPV është edhe Plani i Zhvillimit të Territorit

Ecuria e hartimit, miratimit dhe rishikimit të PPV-ve:

- 48 PPV janë miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe kanë hyrë në fuqi: Belsh, Berat, Cërrik, Devoll, Dibër, Divjakë, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Gramsh, Himarë, Kavajë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Korçë, Krujë, Kuçovë, Kukës, Kurbin, Lezhë, Librazhd, Lushnjë, Malësi e Madhe, Maliq, Mat, Mirditë, Patos, Përmet, Poliçan, Përrenjas, Pukë, Pustec, Roskovec, Rrogozhinë, Sarandë, Shkodër, Skrapar, Tiranë, Tropojë, Ura Vajgurore, Vau i Dejës, Vlorë, Vorë, Mallakastër, Peqin, Has
- 7 PPV janë në proces zbardhje (janë miratuar nga KKT): Bulqizë, Delvinë, Durrës, Finiq, Fushë-Arrëz, Has, Libohovë, Pogradec.
- 5 PPV duhet që të miratohen në Këshill Bashkiak: Shijak, Dropull, Memaliaj, Tepelenë, Selenicë.
- 1 PPV është në proces hartimi: Kamëz
- 26 bashki - kanë ndërmarrë nismat për rishikimin e parashikimeve të PPV-ve, për disa pjesë të territorit, bazuar kryesisht në kërkesat për zhvillim për investime strategjike, apo për infrastrukturë publike. Ndryshimet kërkohen pasi gjatë hartimit fillestar nuk është parashikuar niveli i zhvillimit në përputhje me interesin aktual të bashkisë apo investitorëve strategjikë. Ndryshimet/rishikimi i PPV-ve realizohet me angazhimin e stafit të Bashkisë dhe AKPT-së, nëpërmjet Procedurës së Përshpejtuar.

Gjithashtu, në lidhje me Planet e Detajuara Vendore (PDV), AKPT ka ofruar asistencë teknike NJVV në hartimin e PDV dhe botimin e plotë në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit të vendimit të miratimit nga kryetari i bashkisë dhe dokumenteve përbërëse të PDV-së.

AKPT raporton se në kuadër të kompetencave administruese të sistemit e-planifikimi, rezulton se për vitin 2020 të jenë ndërmarrë në total 94 aplikime për PDV, ndër të cilat janë miratuar në total 32 PDV (të ndara sipas tabelës në vijim) dhe 69 aplikime janë ende në proces.

**Tabela 1:** Lista e PDV-ve të Miratuara për vitin 2020 / e-Planifikimi

Bashkia	Fier	Himare	Kavaje	Kruje	Lezhe	Lushnje	Malësi e Madhe	Shkodër	Tirane	Vau Dejës	Vlore	TOTAL
Nr. PDV-ve të Miratuara 2020	2	7	1	1	2	1	1	9	4	2	2	32

E-Planifikimi ose Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit, i cili me strukturën dhe funksionalitetet e tij mundëson më shumë transparencë në proceset e planifikimit, është

organizuar në vetvete mbi bazën e dy komponentëve kryesore: 1. Platforma e ndërveprimit ndërinstytucional- e-platforma; dhe 2. Harta interaktive GIS- e-harta.

Platforma e Ndërveprimit Ndërinstytucional të Regjistrimit Kombëtar të Planifikimit të Territorit, *e-platform*, e cila ka nisur të funksionoj nga data 29.07.2019, ka si qëllim realizimin e bashkërendimit të proceseve planifikuese, duke nisur nga ndërmarrja e nismës për hartimin e planeve deri në miratimin e tyre final. E-platforma është e dedikuar vetëm për përdorues punonjës në administratën vendore dhe qendrore.

Publiku i cili do të informohet lidhur me proceset planifikuese në territor, ka në dispozicion e-hartën në formatin GIS ku shfaqen informacionet hapësinore për gjendjen ekzistuese dhe atë të planifikuar të territorit, mbi infrastrukturën, ndërtesat, infrastrukturën inxhinierike, projektet strategjike, planet e detajuara vendore. E-harta është një mjet ndihmës për të interesuarit lidhur me proceset planifikuese dhe është në përditësim të vazhdueshëm sipas përcaktimeve të dokumenteve të miratuara të planifikimit të territorit.

**Në kuadër të aktivitetit A1.1, masa b,** (*Asistencë për harmonizimin dhe zbatimin e Programeve Buxhetore Afatmesme*), nga MFE është raportuar se është punuar në hartimin e formateve të planifikimit të shpenzimeve për PBA-të për NJVV-të në bashkëpunim me donatorët. Për periudhën Janar- Dhjetor 2020 aktiviteti është realizuar në masën 40/% të tij, ku sipas planit të veprimit synohet që ky tregues të finalizohet deri në fund të vitit 2022.


Vlen të theksohet se në vazhdimësi do të vijoj puna për dizejnimin dhe hartimin e Sistemit të Integruar të Informacionit të Menaxhimit Financiar Shqiptar (AFMIS - Albanian Financial Management Information System) edhe në nivel vendor. Ky sistem synon që të maksimizojë efikasitetin dhe transparencën e planifikimit, ekzekutimit dhe raportimit të buxhetit si në nivel qendror edhe atë vendor. Hapa konkrete janë ndërmarrë për nivelin qendror ndërkohë që në nivelin vendor është në hapat e para të implementimit dhe kërkon një mbështetje të vazhdueshme me ekspertizë dhe financiare që të mund të realizohet edhe për këtë nivel qeverisës.

**Në kuadër të aktivitetit A1.1, masa c,** (*Hartimi i udhëzuesve teknikë këshillues mbi bashkëpunimin ndërbashkiak për tipe të ndryshme shërbimesh*), MB/AMVV kanë iniciuar analiza të ndryshme të cilat kanë efekt në disa NJVV. Në këtë kuadër mund të përmendim VKM për tarifën e shërbimit zjarrfikës që NJVV-të i ofrojnë njëra tjetrës e cila mundëson një ndërveprim të këtij shërbimi sa më efektiv mes NJV-ve.

**Në kuadër të aktivitetit A1.1, masa d,** (*Përmirësimi i sistemeve të monitorimit të zbatimit të politikave në nivel vendor*), gjatë vitit 2020 filloi procedura për ristrukturimin e AMVV-së si dhe drejtoria që mbulon çështjet e pushtetit vendor në MB. Në MB u bë një ndarje midis politikave strategjike të çështjeve vendore dhe prefekturave si dhe në nivel sektori midis monitorimit dhe politikave të decentralizimit. Kjo ndarje garanton një funksionim më të mirë për pjesën e monitorimit të strategjisë por edhe në të njëjtën kohë në implementimin e politikave në kuadër të procesit të decentralizimit. Referuar kësaj strukture, MB ka mundësinë që jo vetëm të garantoj një proces monitorimi konsistent por edhe të ketë strukturat e përshtatshme për të ndërlidhur këtë strategji me strategjitë e tjera të cilat kanë një ndërveprim reciprok mes tyre. Në mënyrë më të plotë pjesa e organogramës së MB për çështjet vendore sipas sektorëve specifik, e cila hyri në fuqi në fillim të vitit 2021, paraqitet në figurën 1.




**Figura 1:** Struktura e Ministrisë së Brendshme lidhur me çështjet vendore



Për të garantuar një ndarje më të mirë të përgjegjësiave dhe po ashtu për një funksionim më të mirë në procesin e monitorimit, edhe AMVV u ristrukturua duke u ndarë në 3 sektorë të cilët specifikojnë qartë pjesën e detyrave në kuadër të mbështetjes së NJVV-ve. Kjo ndarje u mbështet edhe nga një studim i zhvilluar gjatë vitit 2020 për të trajtuar problematikat funksionale që AMVV kishte dhe sesi këto problematika mund të reflektoheshin nëpërmjet ristrukturimit të saj. Struktura e re organizative e cila u bë funksionale në vitin 2021 paraqitet në figurën 2, si vijon.

**Figura 2:** Struktura e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore



**Në kuadër të aktivitetit A1.1, masa dh,** (Krijimi i strukturave të menaxhimit të Performancës në Bashki sipas kërkesave të nenit 33 të ligjit 139/2015), gjatë vitit 2019 me mbështetjen e projektit STAR 2 u ndërmor një analizë e detajuar e strukturave të bashkive dhe në të njëjtën kohë e detyrimeve që kanë bashkitë për të plotësuar strukturat e tyre në konsistencë me ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” dhe atyre sektoriale. Këto struktura referuese ju mundësuan të gjitha bashkive të cilat u ristrukturuan në vitin 2020. Gjithsesi vlen të theksohet se nuk ka një raportim të saktë të bashkive të cilat e kanë një strukturë të mirëfillte të menaxhimit të performancës. Po ashtu në këtë kuadër gjatë vitit 2020, në kuadër të disa projekteve që janë duke operuar në nivel vendor, si STAR, Bashki të Forta, Bashki për Evropën, etj. u ndërmorën një sërë analizash për të përcaktuar indikatorët dhe pasaportat respektive për monitorimin e standardeve në nivel vendor.

### **A1.2 Forcimi i kapaciteteve vendimmarrëse dhe monitoruese të organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore**

**Në kuadër të aktivitetit A1.2, masa a,** ( *Programi i udhëheqjes për kryetarët e rinj të 61 bashkive* ) vlen të theksohet se kjo iniciativë u ndërmor që në vitin 2019 me zgjedhjet vendore të zhvilluara gjatë këtij viti. MB/AMVV përgatitën një set të plotë të dokumentesh për kryetarët e rinj të bashkive. Po ashtu me mbështetjen e projektit Bashki të Forta janë përgatitur udhëzues për trajtimin e peticioneve dhe konsultimeve si dhe janë zhvilluar një sërë trajnimesh nëpërmjet Shoqatës së Këshillave të Qarqeve.

Përsa i përket masave:

- b. Programi i udhëheqjes për këshillat bashkiakë dhe sekretaret e Këshillave Bashkiak. Krijimi i Sekretariateve të këshillave
- c. Vlerësimi i nevojave për ngritje kapacitetesh të këshillave vendorë
- ç. Plan trajnimi i përshtatur për nevojat specifike të këshillave vendorë dhe i Sekretarëve të Këshillave

ka disa iniciativa nga donatorë të cilët janë të përfshirë në pushtetin vendor por që për vitin 2020 nuk ka një dokument konkret të miratuar nga strukturat përkatëse.

**Në kuadër të aktivitetit A1.2 masa d,** (*Hartimi i rregulloreve për Këshillat Bashkiak*), vlen të theksohet që gjatë vitit 2020 mbi 90% e Këshillave Bashkiak të NJVV-ve kanë miratuar Rregulloren e Brendshme të tyre në konsistencë me kërkesat e ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” në bashkëpunim me AMVV dhe në mënyrë konsistente ka vazhduar mentorimi për zbatimin e tyre.

Në kuadër të **forcimit të kapaciteteve të nëpunësve civile vendorë, masa dh,** ASPA në mënyrë konsistente zhvillon procesin e vlerësimit të nevojave për trajnim për të gjithë punonjësit në nivel qendror, vendor dhe institucionet e pavarura. Po ashtu edhe gjatë vitit 2020 u mblodhën nevojat për trajnime nga të gjitha institucionet e nivelit qendror, vendor dhe institucionet e pavarura për periudhën 2021-2022. Në vitin 2020 ASPA ka trajnuar 6,130 punonjës nga niveli vendor për vitin 2020.

### **A1.3 Rritja e kapaciteteve institucionale të bashkive të reja me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike.**

Aktivitetit A1.3 është i lidhur ngushtësisht me aktivitetet e ASPA e cila gjatë vitit 2020 ka rritur ndjeshëm pjesën e trajnimeve në nivelin vendor.

**Në kuadër të aktivitetit A1.3 masën a, (Identifikimi në mënyrë periodike i nevojave për trajnim nëpërmjet Analizës së Nevojave për Trajnim (ANT), ASPA zhvillon periodikisht analizën e nevojave për trajnim ANT. Ky proces pasqyron nevojat e mbledhura nga pyetësi i ANT, korniza strategjike, detyrimet ligjore dhe dokumente të tjera specifike. ASPA kryen vlerësimin e nevojave për trajnim (ANT) çdo dy vjet dhe në fund të çdo viti rifreskon të dhënat duke kontaktuar institucionet. Vlerësimi gjithëpërfshirës i nevojave për trajnim u zhvillua në fund të vitit 2018 për periudhën 2019-2020; Në fund të vitit 2019 ASPA kontaktoi të gjitha institucionet për të rifreskuar të dhënat dhe për të pasqyruar këto të dhëna në kalendarin e trajnimit të vitit 2020. ANT e fundit u zhvillua në dhjetor 2020 për periudhën 2021-2022. Përveç vlerësimit të përgjithshëm të nevojave për trajnim, ASPA ka gjeneruar raportet individuale të nevojave për trajnim të 61 bashkive dhe këshillave të qarkut. ASPA kreu vlerësimin specifik të nevojave për trajnim për njësitë e vetëqeverisjes për planifikimin dhe buxhetimin e përgjigjshëm gjinor për periudhën 2021-2020 dhe në bazë të kësaj ANT po zhvillon kalendarin përkatës të trajnimeve.**

**Në kuadër të aktivitetit A1.3 masa b, (Rritja e numrit të moduleve të trajnimit të akredituara për administratën vendore dhe regjistruar në e-library), ASPA ka raportuar se gjatë vitit 2020 ASPA ka trajnuar 6,130 pjesëmarrës nga pushteti vendor ose 30% më shumë se viti 2019 gjatë të cilit kanë marrë pjesë 4,827 pjesëmarrës. Gjatë viti 2020 ka pasur rritje të pjesëmarrësve nga bashkitë e vogla dhe të largëta, duke shfrytëzuar trajnimin online. ASPA ka organizuar trajnimin e detyrueshëm për të gjithë nëpunësit civil në periudhë prove, edhe gjatë periudhës së COVID-19, duke e zhvilluar këtë trajnim online.**

Përveç trajnimeve të tjera, janë zhvilluar edhe trajnime të dedikuara për pushtetin vendor si Financa vendore; Buxheti i Përgjigjshëm Rom në pushtetin vendor; Dhuna në familje dhe roli i autoriteteve përgjegjëse; Etika, konflikti i interesit dhe mekanizmat antikorrupsion në pushtetin vendor; Decentralizimi dhe qeverisja vendore; Roli i Këshillave Bashkiakë në monitorimin e dhunës me bazë gjinore; Roli i Pushtetit Vendor në menaxhimin e situatës COVID-19 dhe Parimet e qeverisjes së mirë. Kjo larmishmëri programesh ka bërë të mundur që kapacitetet e stafit të NJVV-ve të rriten në konsistencë me funksionet që ato kanë dhe në të njëjtën kohë tu mundësojnë punonjësve një njohje më të mirë të aspekteve specifike të lidhura me pushtetin vendor.

**Në kuadër të aktivitetit A1.3 masa c, (Zbatimi i procesit detyrues (procedural dhe institucional) për bashkërendimin dhe certifikimin e trajnimeve të ofruara nga partnerët e zhvillimit, nëpërmjet ASPA-s), gjatë vitit 2020 ASPA ka bashkëpunuar me partnerë të ndryshëm gjatë vitit 2020 për zhvillimin e trajnimeve me pushtetin vendor.**

Në bashkëpunim me Programin e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, ROMACTED zhvilluan webinarin “Buxheti i Përgjigjshëm Rom dhe Egjiptian” me pushtetin vendor, me bashkitë Përmet, Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë, Roskovec, Pogradec ku morën pjesë 192 pjesëmarrës.

Në bashkëpunim me Centro Informazione e Educazione allo Sviluppo Onlus (CIES) ka zhvilluar trajnimet me pushtetin vendor për Financat e vetëqeverisjes vendore dhe buxheti i përgjigjshëm gjinor në PBA” në kuadër të projektit “Gra dhe burra të lirë nga dhuna në Shqipëri.

Mbështetje e politikave vendore për mundësi të barabarta”, me mbështetjen financiare të Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim (AICS). Në trajnimet e zhvilluara me këtë bashkëpunim kanë marrë pjesë 116 Pjesëmarrës.

Në bashkëpunim me Projektin Bashkitë për në Evropë gjatë vitit 2020 janë zhvilluar trajnime në kuadër për “Integrimin Evropian në Nivel Vendor” në kuadër të forcimit të kapaciteteve administratave lokale të bashkive në lidhje me BE-në, politikat dhe programet e saj.

Gjithashtu u zhvillua edhe trajnimi online "Fondet e Bashkimit Evropian dhe Shkëmbimi i Përvojave me Vendet Anëtar.

Në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta, u zhvilluan trajnime me zyrtarët përgjegjës për arsimin parashkollor në 61 bashki mbi rolin e psikologut gjatë COVID 19 dhe trajnime me 61 kryetarë të komisioneve të barazisë gjinore mbi rolin e Këshillave Bashkiakë në monitorimin e dhunës me bazë gjinore.

Aktivitetet e zhvilluara në kuadër të kësaj mase janë mbuluar nga funde të huaja të ofruara nga donatorët që mbulojnë fushat specifike të trajnimeve të zhvilluara.

#### **A1.4. Përmirësimi i kushteve dhe sistemeve të menaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor (Shtrirja e "Administrata.al" në nivelin vendor).**

**Në kuadër të aktivitetit A1.4 masa a,** *(Përdorimi i platformës administrata.al për menaxhimin e burimeve njerëzore)* vlen të theksohet që Platforma Administrata.al është vënë në funksion gjatë vitit 2019, sipas raportimit nga DAP. Kjo platformë është krijuar për të mundësuar unifikimin dhe standardizimin e procedurave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përmirësuar komunikimin midis specialistëve të burimeve njerëzore në nivel qendror dhe vendor. Gjatë vitit 2020 platforma rezultoi si një mjet i rëndësishëm gjatë kohës së kufizimit për shkak të pandemisë pasi jo vetëm bëri të mundur realizimin e proceseve të rekrutimit plotësisht online por dhe shërbeu si një vend pune virtual për profesionistët e burimeve njerëzore. Platforma ka lehtësuar punën gjithashtu duke vënë në dispozicion të nëpunësve civil në nivel qendror dhe lokal të gjithë bazën ligjore, template të gatshme, module me hapa të detajuar për procese të rëndësishme të menaxhimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil si ristrukturimi, rekrutimi, vlerësimi i rezultateve në punë, përshkrimi i punës etj. Në këtë platformë janë të regjistruar 180 përdorues nga njësitë e qeverisjes vendore.

**Në kuadër të aktivitetit A1.4 masa b,** *(Rritja e numrit të moduleve të realizuara nëpërmjet platformës "Administrata.al"* DAP ka raportuar se që në momentin e krijimit të kësaj platforme janë marrë masat për ngritjen e moduleve kryesore të cilat lehtësojnë dhe unifikojnë punën e nëpunësve në fushën e burimeve njerëzore në nivel qendror dhe lokal. Platforma deri në fund të vitit 2020 ka të integruar këto module:

- Rekrutimi;
- Përshkrimet e punës;
- Vlerësimi i performancës;
- Dekriminalizimi;
- Proceset gjyqësore;
- nevojat për trajnim;
- vendime të formës së prerë;

- ristrukturimi;
- gjyqet;
- vlerësimi i kostove administrative;
- dhe raportime.

Përveç moduleve platforma përmban dhe proceset kryesore të punës në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe rubrikën e raporteve dhe indikatorëve kryesorë në fushën e raportimit.

**Në kuadër të aktivitetit A1.4 masa c,** (*Trajnimi i nëpunësve të burimeve njerëzore për përdorimin e "Administrata.al"*) referuar të dhënave nga **DAP** 'Trajnimi është mundësuar për të gjithë përdoruesit e regjistruar në platformë. Deri në fund të vitit 2020 janë trajnuar 700 përdorues të platformës. Me qëllim vënien në funksionim të platformës dhe përfitimin maksimale prej platformës, janë zhvilluar seanca trajnimi intensive "Training of Trainers" në fillim me punonjësit e DAP, e më tej në bashkëpunim me DAP u trajnuan punonjësit e tjerë të administratës publike nga sektorët e burimeve njerëzore dhe ligjorë duke përfshirë këtu dhe qeverisjen vendore.

**Në kuadër të aktivitetit A1.4 masa ç,** (*Përgatitja e manualeve dhe udhëzimeve për vlerësimin e punës dhe sistemin e klasifikimit të vendeve të punës i dedikuar për NJVV*), **DAP** ka raportuar se gjatë viti 2020 është hartuar manuali i vlerësimit të rezultateve në punë posaçërisht për Njësitë e Qeverisjes Vendore. Manuali ju vjen në ndihmë nëpunësve civilë në Nivel Vendor për të kryer një vlerësim të performancës bazuar në përcaktimet ligjore dhe objektivizëm. Manuali gjithashtu detajon hapat nëpërmjet të cilave kalon procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, afatet kohore dhe rolin e personave përgjegjës për zhvillimin e plotë të vlerësimit të rezultateve të performancës në nivel vendor. Manuali është përkthyer në gjuhën shqipe dhe pas miratimit të tij do të mundësohet zhvillimi i trajnimeve në të gjithë njësitë e qeverisjes vendore (brenda vitit 2021) me mbështetje të ekspertizës së projektit IPA 2014 "Zbatimi i reformës së shërbimit civil në të gjithë administratën publike".

Sa i përket sistemit të klasifikimit të pozicioneve të punës tashmë është hartuar manuali mbi përshkrimet e punës dhe vlerësimin e përshkrimeve dedikuar nivelit vendor. Manuali ndihmon nëpunësit për caktimin e vendeve të punës në nivele të përshtatshme brenda një shkalle hierarkike të pagës dhe është krijuar për t'u zbatuar në të gjitha llojet dhe nivelet e vendeve të punës në shërbimet civile në njësitë e qeverisjes vendore. Ky manual përcakton sfondin që lidhet me zbatimin e vlerësimit të punës dhe ju mundëson nëpunësve të kuptojnë se si është vlerësuar një punë. Edhe për këtë nënaktivitet janë parashikuar trajnime për përvetësimin e njohurive në këtë drejtim dhe diskutimeve përmes përvojës praktike dhe kjo masë është në proces.

**Në kuadër të aktivitetit A 1.4 masa d,** (*Analizë e nivelit të pagave dhe rishikimi (rritja) e nivelit të pagave të nëpunësve në NJVV*), analiza e nivelit të pagës është pjesë e dokumentit të politikës së pagave. Në dokumentin e politikës së pagave janë propozuar shkallët e reja të pagave me opsionet përkatëse ku ndër të tjera propozohet që nëpunësit civil do të paguhen sipas klasifikimit të pozicionit dhe sipas punës që ato kryejnë. Sipas propozimeve në këtë dokument, kategorizimi i pagës fillon nga kategoria më e ulët (punonjës mbështetës) deri tek niveli më i lartë në shërbimin civil. Dokumenti propozon një sistem page të unifikuar i cili konsiston në 114 hapa dhe 16 kategorive (dy kategori për stafin mbështetës dhe 12 për stafin e nëpunësve civil). Për implikimet buxhetore që është dhe një nga aspektet kryesore të kësaj reforme është bërë një përllogaritje për Ministrinë e Kulturës dhe pritet që në bashkëpunim me aktorët e tjerë të kryhen konsultime publik dhe të përllogaritet gjithashtu dhe ndikimi fillimisht për të gjitha ministritë e linjës.

**Në kuadër të aktivitetit A1.4 masa dh,** (*Publikimi i udhëzimeve për menaxhimin e burimeve njerëzore mbi politikën dhe praktikën në nivel vendor*), DAP ka raportuar se udhëzimet për menaxhimin e burimeve njerëzore janë publikuar rregullisht në faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike. Gjatë vitit 2020 për shkak të situatës së jashtëzakonshme të krijuar nga COVID 19, institucionet më shumë se kurrë patën nevojë të reagonin shpejt dhe ndryshe me qëllim vijimin e punës në institucione. Gjatë kësaj periudhe ndryshoi në tërësi mënyra e organizimit të punës në institucionet publike, duke aplikuar të punuarit nga shtëpia. Për të organizuar punën, DAP hartoi një rregullore tip, për ta përdorur më pas të gjitha institucionet e administratës shtetërore. Në mbështetje të mënyrës së re të organizimit të gjithë punonjësit morën trajnime të veçanta për të mundur vijueshmërinë e punës dhe kjo masë është në proces.

**Në kuadër të aktivitetit A1.4 masa e,** (*Përshtatja e formateve standarde për përshkrimin e punës, procedurat e rekrutimit dhe vlerësimin të performancës bazuar në Udhërrëfyesin për menaxhimin e burimeve njerëzore*) DAP ka raportuar se formatet standarde për përshkrimin e punës, proceset e rekrutimit dhe vlerësimin të performancës në punë janë unifikuar dhe janë pjesë e platformës "administrata.al". Përdoruesit në nivel vendor duhet të vënë në zbatim këto formate për të mundur unifikimin e praktikave në fushën e burimeve njerëzore. Ky proces është në vijim.

## **A2. Aplikimi i shërbimeve të integruara administrative me teknologjinë e informacionit për 61 bashkitë dhe njësitë e tyre administrative**

### **A2.1 Bërja funksionale e Zyrave me Një Ndalesë në 61 bashkitë dhe njësitë administrative**

**Në kuadër të aktivitetit A2.1 masa a,** (Riorganizimi funksional i të gjitha zyrave të shërbimeve administrative sipas modelit të zyrës me një ndalesë), me mbështetjen e donatorëve dhe të Qeverisë Shqiptare, zyrat me një ndalesë janë duke u bërë funksionale në të gjitha NJVV-të e vendit. Ky aktivitet i planit të veprimit ka qenë një prioritet i artikulluar i Qeverisë Shqiptare që pas reformës administrativo-territoriale, i konkretizuar me projektin STAR 1 dhe STAR2, dhe vazhdon të jetë një prioritet me anë të asistencës së projektit STAR 3.

Lidhur me raportimin për vitin 2020, MB/AMVV raporton se në fund të vitit 2020, duke marrë në konsideratë të gjithë asistencën e dhënë kumulative nga projekte të ndryshme si STAR 2, plgp dhe dldp, raportohet se të gjitha bashkitë janë të pajisura me zyra me një ndalesë. Nga 61 bashki, në kuadër të projektit STAR 2, 50 NJVV kanë bërë funksionale zyrat e shërbimeve administrative sipas modelit të zyrës me një ndalesë, të pajisura me një pakete me mbi 70 shërbime standarde. Duke marrë në konsideratë edhe zyrat e ngritura më parë, numri i zyrave me një ndalesë shkon në 59. Vlen për t'u përmendur që gjatë punës së ngritjes së zyrave me një ndalesë nga ana e projektit STAR 2, bashkia Roskovec ka kërkuar asistencë për unifikimin e sistemit të saj me standardin e STAR.

Vlen të theksohet se infrastruktura e Teknologjisë së Informacionit në nivel bashkie rezulton me mangësi të konsiderueshme për sa i përket disponueshmërisë në bashki, mbi të gjitha në bashki me financa të kufizuara. Lidhur me planet për vitet në vijim, raportohet se deri në vitin 2022 parashikohet konsolidimi dhe zgjerimi i zyrave të shërbimeve administrative sipas modelit të zyrës me një ndalesë edhe në Njësitë Administrative përkatëse.

**Në kuadër të aktivitetit A2.1 masa b,** (Modernizim i infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë për shërbimet administrative në 61 bashkitë dhe njësitë administrative), gjithashtu me mbështetjen e projektit STAR është dhënë ndihmë teknike për të funksionalizuar sistemet në kuadër të:

- Konfigurimi i rrjedhës së shërbimit sipas organigramës së re;
- Mbështetje në konfigurimin e përdoruesit dhe instalimin e VPN për secilën NJVV;
- Ri-trajnimi i stafit të NJVV-ve;
- Mbështetje në vend gjatë procesit
- Mbështetje një mujore pas transmetimit

**Në kuadër të aktivitetit A2.1 masa c,** (Hartimi i një udhëzimi teknik orientues për mënyrën e delegimit të kompetencës së shërbimit administrativ midis njësive të vetëqeverisjes vendore), me mbështetjen e projektit Bashki të Forta u bë i mundur aprovimi i Procedurave Standarde të Veprimit për Arsimin Parashkollor në bashkitë Shkodër, Kukës, Durrës, Ura Vajgurore, Vlorë dhe Korçë.

**Në kuadër të aktivitetit A2.1 masa ç,** (Ngritja e kapaciteteve të administratave vendore për zbatimin e procedurave të shërbimeve administrative), me mbështetjen e projektit Bashki të Forta ka patur mbështetje konsistente (coaching) në bashkitë Shkodër, Kukës, Durrës, Ura Vajgurore, Vlorë dhe Korçë për zbatimin e Procedurave Standarde të Veprimit në Arsimin Parashkollor.

**Aktiviteti A2.2 (Digjitalizimi i arkivave vendore),** nuk ka patur rezultate konkrete në asnjë prej masave që përfshin.

- a. Studim fizibiliteti për digjitalizimin e arkivave vendore
- b. Digjitalizimi i arkivave vendore

### **Nën-objektivit A3. Forcimi i dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme**

Përsa i përket nën-objektivit A3 (*Forcimi i dialogut mes qeverisë qendrore dhe asaj vendore dhe llogaridhënies së dyanshme*), i cili përbëhet nga 4 aktivitete, rezultate konkrete janë shënuar në secilin prej tyre dhe më konkretisht vihen re në:

#### **A3.1 Fuqizimi i Këshillit Konsultativ**

**Në kuadër të aktivitetit A3.1, masa a,** (*Asistencë teknike për Këshillin Konsultativ dhe Sekretariatit Teknik për koordinimin e veprimtarive dhe analizën e legjislacionit për shqyrtim*), me mbështetjen e BE gjatë vitit 2020 MB/AMVV kanë patur asistencë të dedikuar në kuadër të rritjes dhe zhvillimit të sekretariatit të KK. Kjo asistencë është parashikuar që të jetë edhe gjatë vitit 2021 dhe ka konsistuar në këto drejtime kryesore:

- Të rritet roli i Këshillit Konsultativ në të gjitha ndryshimet legjislative dhe rregulloret që kanë të bëjnë me procesin e decentralizimit;
- Të rriten kapacitetet e stafit të AMVV dhe MB në lidhje me menaxhimin e Këshillit Konsultativ;

- Të rritet roli i NJVV-ve në propozimet ligjore për një funksionalitet më të mirë të detyrave të tyre;
- Të rriten kapacitetet e stafit të NJVV-ve, AMVV, MB, ministrive të linjës, shoqatave dhe institucionit të prefektit në lidhje me kornizën legjislative dhe buxhetore;


**Në kuadër të aktivitetit A3.1, masa b,** (*Hartimi dhe përmirësimi i akteve nënligjore, statute dhe rregulloret e brendshme për funksionimin e KK, përfshirë punën analizuese, (ndër të tjera) buxhetin*), gjatë vitit 2020 u përgatitën skedar standard për projekt aktet në mënyrë që të unifikohet procedura e trajtimit dhe analizimit të tyre dhe gjithashtu të ketë një ndjekje në vijimësi të ecurisë së miratimit të secilit projekt akt.

*Po ashtu në aspektin e dokumenteve strategjik dhe rregullues u hartua dhe miratua Strategjia e Komunikimit dhe e Dukshmërisë për Këshillin Konsultativ Qeveri Qendrore-Vetëqeverisje Vendore. SKD ka për qëllim të konturojë, forcojë dhe të bëjë qartazi të dukshëm e të kuptueshëm profilin e Këshillit Konsultativ, si një platformë zyrtare konsultimi dhe dialogu midis Qeverisjes Qendrore dhe asaj Vendore. Strategjia synon të shërbejë si një urë lidhëse midis anëtarëve të KK dhe audiencës së synuar për të arritur një dukshmëri maksimale mbi punën e vazhdueshme të tij.*

Rregullore e Brendshme e Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore është një tjetër dokument i cili filloj të përgatitej gjatë fundit të vitit 2020. Rregullorja ka për qëllim të përcaktojë në mënyrë të plotë dhe të detajuar rregullat e brendshme për organizimin dhe funksionimin e KK.

**Në kuadër të aktivitetit A3.1, masa c,** (*Forcimi i rolit të Këshillit Konsultativ në procesin ligjvënës*), roli i KK, ka ardhur në rritje dhe intensifikim të tij, sidomos edhe me miratimin e vendimit nr. 751, datë 19.12.2018, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 910, datë 21.12.2016, të Këshillit të ministrave, “për çështjet, objekt konsultimi, dhe Strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të Funksionimit të këshillit konsultativ të qeverisjes qendrore me Vetëqeverisjen vendore”, ku Përbërja e KK u zgjerua dhe ka një përfaqësim të barabartë anëtarësh, 9 (nëntë) përfaqësues të qeverisjes qendrore dhe 9 (nëntë) përfaqësues të vetëqeverisjes vendore. Përsa i përket rezultateve konkrete gjatë vitit 2020 në mbledhjet e KK janë paraqitur për diskutim gjithsej 30 projekt akte ligjore, nga të cilat 9 projekt ligje dhe 21 projekt vendime. Këto projekt akte ligjore janë paraqitur kryesisht nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 11 prej tyre, 4 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, 4 nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, 3 nga Ministria e Brendshme, dhe 3 nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Grafiku 4:** Projekt akte në KK gjatë vitit 2020




Numri i projekt akteve ligjore të miratuara gjatë vitit 2020 ishte 15, që përbën rreth 94% të atyre të diskutuara. Nga këto, janë miratuar të gjitha projekt ligjet e diskutuara dhe 90% e projekt vendimeve.



Gjatë vitit 2020 në Këshill janë paraqitur për diskutim gjithsej 7 nga 58 projekt aktet ligjore të vlefshme të urdhrimit të Kryeministrit nr. 101, datë 03.07.2019; 5 nga 7 projekt aktet ligjore të paraqitura për diskutim janë diskutuar, dhe 4 prej tyre janë miratuar. Gjithsej, rreth 12% e projekt akteve ligjore të parashikuara nga urdhri janë paraqitur për diskutim në Këshill dhe 80% e tyre janë miratuar gjatë vitit 2020.

**Grafiku 5:** Projekt akte në KK gjatë vitit 2020 të urdhrimit të Kryeministrit



**Në kuadër të aktivitetit A3.1, masa ç,** (Rritja e kapaciteteve të Sekretariatit të Këshillit Konsultativ (AMVV-së)), me anë të asistencës teknike të BE është dhënë mbështetje e drejtpërdrejtë për stafin e sekretariatit mbi veprimtarinë e përditshme. Po ashtu janë përgatitur edhe disa pyetësorë për të përcaktuar nevojat e AMVV dhe institucioneve të tjera për trajnime të cilat pritet të zhvillohen gjatë vitit 2021.

**Në kuadër të aktivitetit A3.1, masa d,** (Rritja e rolit të pushtetit vendor në procesin konsultues të projektakteve nëpërmjet mbështetjes së shoqatave të bashkive dhe shoqatës së qarqeve), vlen të përmendet se Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë, Shoqata për Autonominë Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë kanë qenë të pranishme në të gjitha mbledhjet e vitit 2020 të KK. Përsa i përket pjesëmarrjes së bashkive, mesatarisht 12 bashki kanë qenë të pranishme në mbledhjet e vitit 2020, që përbën rreth 20% të bashkive të vendit dhe mesatarisht 9 bashki kanë qenë të pranishme në mbledhjet e vitit 2020 me përfaqësues kryetar.

### **A3.2 “Krijimi i sistemit të standardizuar dhe formalizuar të të dhënave vendore për një vendimmarrje të informuar”**

**Në kuadër të aktivitetit A3.2, masa a,** (Vlerësimi i ngritjes së një sistemi të unifikuar për mbledhjen periodike të informacionit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore), me mbështetjen e projektit STAR është duke u punuar për implementimin e sistemit IPSIS në nivel vendor dhe në të njëjtën kohë edhe për mbledhjen e të dhënave në këtë kuadër. Gjatë vitit 2020 u bë një analizë e detajuar e të gjitha të dhënave të nevojshme për të bërë të mundur vlerësimin e performancës së bashkive në 6 dimensionet e ndryshme:

- D1. Ofrimi i shërbimeve publike vendore;
- D2. Menaxhimi financiar i qëndrueshëm;
- D3. Orientimi afatgjatë i zhvillimit;
- D4. Integrimi i teknologjisë së informacionit;
- D5. Aftësitë dhe kapacitetet vendore;
- D6. Transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja e qytetarëve.

Po ashtu u bë një vlerësim i të dhënave disponibël nga bashkitë me qëllim që ky sistem të jetë sa më i përshtatshëm për të gjitha NJVV-të.

**Në kuadër të aktivitetit A3.2, masa b,** (*Hartimi i formateve standarde për raportimin e informacionit për zbatimin e politikave nga NJVV tek ministrinë e linjës dhe institucionet qendrore dhe anasjelltas*), vlen të theksohet fakti se kjo procedurë është në hapat e para dhe pritet që të implementohet gjerësisht nga sektori i monitorimit në MB. Rezultatet e para në kuadër të kësaj mase pritet të merren gjatë vitit 2021 dhe në të njëjtën kohë të intensifikohet edhe bashkëpunimi me ministrinë e linjës për të përcaktuar treguesit përkatës.

Gjithsesi për disa prej nën-funksioneve ka patur rezultate konkrete nga mbështetja e donatorëve siç është:

- menaxhimi i mbetjeve urbane, ku me mbështetjen e projektit BtF, është hartuar metodologjia për gjenerimin dhe raportimin e të dhënave për mbetjet urbane nga bashkitë. Kjo metodologji përmirëson formatet e raportimit që kërkohen nga bashkitë, sipas VKM nr.687/2015.
- monitorimin dhe raportimin e performancën buxhetore i bashkive i cili në mënyrë të vazhdueshme është përmirësuar dhe standardizuar mes të gjitha bashkive. Në të njëjtën kohë janë zhvilluar edhe trajnime për përgatitjen e buxhetit të qytetarit.

**Në kuadër të aktivitetit A3.2, masa c,** (*Ngritja dhe zbatimi i një sistemi të integruar unik të mbledhjes dhe raportimit të informacionit nga NJVV tek institucionet qendrore nëpërmjet formateve standarde*), nuk ka patur rezultate konkrete gjatë vitit 2020. Kjo masë do të filloj implementimin pasi të ndërtohet sistemi i unifikuar sipas standardeve IPSIS.

**Në kuadër të aktivitetit A3.2, masa ç,** (*Rivlerësim dhe forcim i rolit të Prefektit në funksion të monitorimit të funksioneve vendore*), MB gjatë vitit 2020 përgatiti një draft për rishikim të ligjit të prefektit i cili synon një rishikim të strukturës dhe të kompetencave të prefektit në monitorimin e NJVV-ve. Ky rishikim erdhi si rezultat edhe i një vlerësimi të rolit të prefektit i mundësuar në kuadër të projektit të BtF.

**Në kuadër të aktivitetit A3.2, masa d,** (*Publikimi i Vjetarit Statistikor Bashkiak*), duke qenë se kjo masë është e ndërlidhur me ngritjen e sistemit të të dhënave në nivel vendor, dhe aktualisht nuk ka një sistem të tillë funksional, ky raport nuk është realizuar gjatë vitit 2020.

**Në kuadër të aktivitetit A3.2, masa dh,** (*Publikimi i Raportit Vjetor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi Treguesit e Financave Vendore dhe përshtatshmërinë, parashikueshmërinë dhe barazinë e sistemit financiar ndërqeveritar*) MFE ka raportuar se duke u bazuar në raportin e publikuar sipas njësive vendore është hartuar raporti vjetor. Referuar treguesve financiarë të njësive të vetëqeverisjes vendore që pasqyrohen në raport, kjo masë është realizuar 50% gjatë vitit janar - dhjetor 2020. Gjithashtu është arritur që çdo vit të ketë raporte periodike për sa i përket treguesve financiarë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

### **A3.3. Qartësimi i kompetencave të zhvillimit vendor dhe rajonal**

**Në kuadër të aktivitetit A3.3, masa a,** (*Përcaktimi i prerogativave vendore, rajonale dhe qendrorë në zhvillimin vendor e rajonal (shmangia e mbivendosjes mes politikës së zhvillimit rajonal e vendor)*), nuk ka patur rezultate për vitin 2020.

**Në kuadër të aktivitetit A3.3, masa b,** (Vlerësimi i rolit të këshillit të qarkut në zhvillimin rajonal kombëtar dhe menaxhimin e fondeve të BE-së dhe harmonizimit të strukturave administrative në nivel qarku me zonat e zhvillimit rajonal), gjatë vitit 2020 me mbështetjen e donatorëve u fillua një studim për të përcaktuar më qartë detyrimet funksionale të qarqeve si dhe kompetencat e tyre, studim i cili ende nuk ka dalë me disa rekomandime konkrete mbi përmirësimin funksional të strukturës së qarkut.

**Në kuadër të aktivitetit A3.3, masa c.** (Vlerësimi i kompetencave të këshillit të qarkut për shërbimet rajonale dhe hartimi i rekomandimeve për ligjvënësin për organizimin e ardhshëm të nivelit të dytë të qeverisjes vendore) nuk ka patur rezultate për vitin 2020.

#### **A3.4 Përcaktimi i kushteve, rregullave dhe procedurave për decentralizimin asimetric të funksioneve**


Në kuadër të aktivitetit A3.4, nuk ka patur rezultate konkrete në asnjë prej masave të përfshira në të:

- a. Studim për nevojat për decentralizim asimetric
- b. Kriteret për vlerësimin e gatishmërisë së bashkive sipas funksioneve specifike dhe tipareve të veçanta
- c. Hartimi i kuadrit ligjor të posaçëm (për kryeqytetin)

#### **4.2. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik B:**


Objektivi specifik “Forcimi i financave vendore dhe autonomisë fiskale” përbëhet nga 5 nën-objektiva dhe 11 aktivitete dhe 21 masa (5 aktivitete kanë nga një masë). Ky objektivi specifik, ka si institucion përgjegjës MFE-në për të gjithë aktivitetet. Në kuadër të këtij objekti specifik MFE ka raportuar në mënyrë specifike për masat në të cilat ka patur realizime korente gjatë vitit 2020. Nga raportimi rezulton që në të gjithë nën-objektivat ka patur hapa konkrete në realizimin e tyre, ndërsa në nivel aktivitetesh ka patur rezultate në 6 prej 11 që janë në total dhe në nivel masash ka patur rezultate në 14 nga 21.

**Grafiku 6:** Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik B



Në kuadër të këtij objektivi specifik në SKNDQV janë përcaktuar edhe disa indikatorë matës. Përsa i përket indikatorit B.1 - Buxheti i qeverisjes vendore në raport me PBB (%)rezulton që vlera e synuar për vitin 2020 ishte të arrinte në 4% ndërkohë që vlera e realizuar është 3.28%, ndërkohë që deri në vitin 2022 kur përfundon periudha e planit të veprimit të SKNDQV synimi është që buxheti i qeverisjes vendore të arrij në 5% të PBB-së. Përsa i përket nivelit të të ardhurave të veta në vitin 2019 rezulton që zinin 1.49% të PBB ndërkohë që në vitin 2020 zinin 1.4% të PBB, rreth 0.25 pikë përqind më poshtë krahasuar me synimin për këtë vit. Në vitin 2022 ky tregues synohet që të arrij vlerën e 1.75% e PBB-së.

**Grafiku 7:** Vlerësimi i Indikatorëve për Objektivin Specifik B për vitin 2020



Indikatorit tjetër i raportuar lidhet me nivelin e të ardhurave të qeverisjes vendore mbi të cilat ajo ka diskrecion vendimmarrës për burimin e financimit (të ardhurat e veta; taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuara dhe specifike) i cili në vitin 2019 si viti bazë përbënin 3.1% të PBB ndërkohë që në vitin 2020 përbënin 3.02% nga 3.2% që ishte niveli i synuar për vitin 2020, kjo për shkak edhe të pandemisë që ka qenë gjatë vitit 2020, ndërkohë që niveli i synuar për vitin 2022 është 3.5% e PBB.

Pjesë e këtij objektivi strategjik është edhe një indikator i lidhur me numrin e bashkive që marrin vlerësim të lartë për sistemet e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, i cili është realizuar në vitin 2018 në 9 bashki ndërkohë që në vitin 2020 ishte parashikuar të realizohej në 15 bashki por që rezulton i pa arrirë si objektivi pasi nuk është bërë një vlerësim i tillë në 2020.

Në mënyrë më të detajuar rezultatet për secilin nën-objektiv, aktivitetet dhe masë duke u ndalur në të gjitha rezultatet për secilin paraqiten në vijim.

**Nën-objektivi B1 “Konsolidimi i sistemit të të ardhurave të veta vendore dhe administrimit fiskal vendor”**

Përsa i përket nën-objektivit B1 (*Konsolidimi i sistemit të të ardhurave të veta vendore dhe administrimit fiskal vendor*), i cili ka 1 aktivitet (*B1.1, Rritja e kapacitetit të të ardhurave vendore të NJVV për të përmbushur nevojat financiare për ofrimin e më shumë shërbimeve*) dhe 5 masa në mënyrë specifike rezulton se:

**Në kuadër të aktivitetit B1.1, masa a, (Hartimi dhe implementimi i ligjit mbi taksën pasurisë së paluajtshme në nivel vendor),** gjatë vitit 2020 është miratuar hartimi dhe aprovimi i ligjit dhe zbatimi nga NJVV dhe më pas miratimi i 'Ligjit të ri mbi taksimin e pasurive të paluajtshme ndërtesa sipas vlerës së tregut është hartuar dhe do të nënshtrohet procesit të konsultimit.

**Në kuadër të aktivitetit B1.1, masa b, (Popullimi me të dhëna i kadastrës fiskale),** MFE shprehet se në nivel qendror është punuar për lehtësimin e mënyrave të regjistrimit si dhe integrimin e të dhënave nga burime të ndryshme në ndihmë të popullimit nga bashkitë. Ritmet e punës nga stafet e NJVV të cilat kanë detyrimin ligjor të popullimit të sistemit kanë qenë në nivele të ulëta. Në këtë drejtim nevojitet përmirësim i konsiderueshëm në ritmet e punës nga stafet e NJVV pasi mbarëvajtja dhe suksesi i proceseve të taksës së pasurisë kërkon një nivel të lartë të popullimit me të dhëna të sistemit.

**Në kuadër të aktivitetit B1.1, masa c, (Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve teknike e institucionale vendore për administrimin fiskal, me fokus në taksën e pasurisë dhe tarifave vendore),** vlen të theksohet se nëpunësit e trajnuar të NJVV-ve mbi proceset e taksës së pasurisë dhe sistemit të Kadastrës Fiskale kanë vazhduar trajnimet edhe gjatë 2020, sipas planit të implementimit dhe kërkesave.

Ndërkohë që në kuadër të këtij aktiviteti janë të pa filluara dy masa të cilat lidhen me hartimin e një manuali procedural për administrimin e taksave në nivel vendor dhe konsolidimin dhe qartësimin e kornizës ligjore mbi taksat dhe tarifave vendore.

## **Nën-objektivi B2 "Rritja e ndarjes së të ardhurave nga taksat kombëtare me bashkitë"**

Përsa i përket nën-objektivit B2 (*Rritja e ndarjes së të ardhurave nga taksat kombëtare me bashkitë*), i cili përbëhet nga 2 aktivitete, rezultate konkrete vihen re në:

### **B2.1 Zbatimi i ndarjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 68/2017, "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"**

**Në kuadër të aktivitetit B2.1, masës a, (Hartimi i Udhëzimit dhe mënyrën e përlllogaritjes së ndarjes midis njësive të vetëqeverisjes vendore së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale),** udhëzimi është përfunduar dhe në udhëzimin e zbatimit të buxhetit për vitin 2021, është shtuar një pjesë e cila lidhet me mënyrën e përlllogaritjes dhe të shpërndarjes së TAP. Më specifikisht në pikën 104 të këtij udhëzimi njësitet e vetëqeverisjes vendore janë përfituese të 2% nga tatimi mbi të ardhurat personale që realizohen në juridiksionin e tyre, i cili shpërndahet çdo 4 muaj pas publikimit të treguesve fiskalë. Ndërkohë kriteri i shpërndarjes bëhet duke ju referuar numrit të popullsisë për çdo bashki që është përdorur për shpërndarjen e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021.

**Në kuadër të aktivitetit B2.1, masës b (Zbatimi i ndryshimeve të nevojshme (ndërlidhja) në sistemin informatikë të administratës tatimore qendrore për të mundësuar identifikimin e plotë të rezidencës së tatimpaguesve),** sistemi është i përfunduar por për mënyrën e identifikimit të plotë të rezidencës së tatimpaguesve janë zhvilluar disa diskutime, por ende nuk ka rezultate konkrete.

### **B2.2 Rritja e ndarjes së të ardhurave nga taksat e rentës minerare për njësitet e vetëqeverisjes vendore nga niveli aktual prej 5% në 8%**

**Në kuadër te aktivitetit B2.2, masës a,** *(Ndryshimi i kuadrit ligjor për të reflektuar rritjen e pjesës takuese të njësive të vetëqeverisjes vendore nga renta minerare),* MFE ka zhvilluar disa diskutime për ndryshimin e përqindjes së rentës minerale për të reflektuar rritjen e pjesës që do të marrin njësitë e vetëqeverisjes vendore krahasuar me atë aktuale, por ende nuk ka rezultate konkrete në këtë drejtim. Kjo ka qenë një kërkesë konsistente nga bashkitë që kanë burime minerare, pasi niveli aktual prej 5% i shumës së rentës që i transferohet NJVV-ve nga industria minerare është i ulët dhe nuk vendos një raport të drejtë me banorët e këtyre zonave, për më tepër rritja e kësaj norme edhe pse do të kishte një efekt negativ në buxhetin e shtetit do të garantonte një qëndrueshmëri të financave vendore të NJVV-ve që preken dhe një zhvillim më gjithëpërfshirës të rajoneve të vendit.

**Në kuadër te aktivitetit B2.2, masës b,** *(Ngritja e një sistemi raportimi dhe rakordimi midis administratës qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për masën e rentës minerare të pagueshme),* aktualisht MFE raporton Akt-rakordimet midis tatimeve dhe doganave me njësitë vendore. Gjithashtu gjatë vitit 2020 ka vazhduar shpërndarja e rentës minerare bazuar në akt-rakordimet midis njësive vendore dhe tatimeve/doganave sipas legjislacionit në fuqi.

### **Nën-objektiv B3. “Përmirësimi i parashikueshmërisë, stabilitetit dhe përshtatshmërisë së sistemit të transfertave ndërqeveritare”**

Përsa i përket nën-objektivit B3 (Përmirësimi i parashikueshmërisë, stabilitetit dhe përshtatshmërisë së sistemit të transfertave ndërqeveritare), i cili përbëhet nga 2 aktivitete, rezultate konkrete vihen re në:

#### **B3.1, Rritja graduale e financimit për transfertën e pakushtëzuar për të akomoduar financimin e funksioneve të reja të transferuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Vendore**

**Në kuadër të aktivitetit B3.1, masa a,** *(Përmirësimi i skemës së financimit të arsimit parashkollor duke synuar që transferta të ndahet kryesisht mbështetur mbi numrin e fëmijëve 3-6 vjeç),* gjatë vitit 2020 në ligjin e buxhetit të miratuar është reflektuar dhe realizuar shpërndarja e fondeve për bashkitë në buxhetin e vitit 2020.

**Në kuadër të aktivitetit B3.1, masa b,** *(Nën drejtimin e Këshillit Konsultativ, publikimi i një raporti vjetor mbi përshtatshmërinë, parashikueshmërinë, transparencën dhe drejtësinë e sistemit financiar ndërqeveritar, përfshirë transferrat e kushtëzuara për investime në nivel vendor)* është përgatitur raporti për ecurinë e treguesve buxhetor sipas bashkive dhe qarqeve për vitin 2020.

Raporti i vitit 2020 është raporti i tretë zyrtar i MFE për zbatimin e buxhetit vendor. Gjithsesi vlen të theksohet që gjatë vitit 2020 u mundësua një unifikim i proceseve të menaxhimit të financave publike në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, si në aspektin metodologjik duke respektuar të njëjtat parime si niveli qendror dhe në plotësimin e të gjitha kërkesave ligjore. Raporti paraqitet një analizë të detajuar të tendencave dhe situatës financiare të pushtetit vendor si dhe synon të evidentojë burimet e financimit të NJVQV-ve, shpenzimet për ushtrimin e funksioneve dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve financiare për vitin 2020. Raporti bën një analizë të detajuar edhe aspekti krahasimor deri në vitin 2020 për të patur një qasje të plotë të efektivitetit financiar si rezultat i politikave të ndërmarra por edhe të paraqes objektivat që priten të zbatohen gjatë vitit 2021.

**Në kuadër të aktivitetit B3.2, (Rritja e parashikueshmërisë dhe stabilitetit të sistemit të financimit të funksioneve vendore me transferta të kushtëzuara),**

a. Hartimi i një studimi mbi funksionet vendore që financohen me transferta të kushtëzuara, nevojat e bashkive për financim në këto funksione dhe mundësitë e financimit me transferta të kushtëzuara të njësive të vetëqeverisjes vendore nga buxheti i shtetit

b. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për financimin me grante të kushtëzuara të funksioneve vendore apo projekteve kapitale në sektorë strategjikë për njësitë e vetëqeverisjes vendore.

nuk ka patur rezultate të matshme në asnjë prej masave që përbëjnë këtë aktivitet.

**Nën-objektiv B4. “Rritja e kapaciteteve të NJVV që të përdorin huamarrjen për financimin e projekteve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik”**

Përsa i përket nën-objektivit B4 (*Rritja e kapaciteteve të NJVV që të përdorin huamarrjen për financimin e projekteve kapitale, brenda politikave kombëtare të borxhit publik*), i cili përbëhet nga 2 aktivitete, rezultate konkrete vihen re në kuadër të aktivitetit B4.2 (*Hartimi i kuadrit nënligjor për parandalimin dhe menaxhimin e problemeve dhe vështirësive financiare në nivel vendor*), ku MFE ka miratuar një udhëzim i cili ka për qëllim që të zbatojë një sistem monitorimi në mënyrë që të identifikojë njësitë të cilat kanë probleme financiare.

Gjithashtu është përgatitur edhe një raport për situatën e vështirësive financiare sipas bashkive, i cili jep një pamje më të plotë të bashkive sipas nivelit të riskut.

**Nën-objektiv B5. “Forcimi i sistemit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor”**

Përsa i përket nën-objektivit B5 (*Forcimi i sistemit të menaxhimit të financave publike në nivel vendor*), në fund të vitit 2019 u rishikua strategjia për Menaxhimin e Financave Publike për periudhën 2019-2022. Në këtë strategji janë përcaktuar objektivat strategjikë në drejtim të rritjes së efektshmërisë dhe efikasitetit të menaxhimit financiar në nivel vendor. Ky nën-objektiv përbëhet nga 4 aktivitete, rezultate konkrete vihen re në:

**B5.1 Përmirësimi i kapaciteteve të përgjithshme të NJVV-ve në fushën e menaxhimit financiar publik**

**Në kuadër të aktivitetit B5.1, masa a,** (Forcimi i kapaciteteve dhe zbatimi i instrumenteve për hartimin, zbatimin, raportimin, vlerësimin dhe auditimin e buxheteve vendore), MFE në mënyrë konsistente mbështet të gjitha njësitë vendore që kanë përgjegjësi implementimin në të gjitha aspektet të buxhetit vendor me asistencë të dedikuar nëpërmjet njësisë së saj.

**Në kuadër të aktivitetit B5.1, masa b,** (*Konsolidimi i procesit të buxhetimit PBA në të gjitha NJVV-të*), vlen të theksohet se monitorimi i zbatimit të buxhetit si pjesë përbërëse e procesit të menaxhimit financiar në nivel vendor është unifikuar me miratimin e udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Referuar këtyre standardeve, sipas MFE, PBA-të e njësive vendore janë të plotësuara sipas formateve të

miratuara komfort këtij udhëzimi. Gjithashtu, Ministria e Financave dhe Ekonomisë raporton edhe për Raportin e Përputhshmërisë për vitin 2019-2020.

**Në kuadër të aktivitetit B5.1, masa c, (Hartimi i raporteve të monitorimit të performancës funksioneve/shërbimeve vendore sipas programeve buxhetore), raportet janë të përfunduara si dhe bashkitë kanë paraqitur raportet e monitorimit për vitin 2020, MFE ka komentuar dhe argumentuar plotësimin e tyre.**

**B5.2. Evidentimi i problemeve të kontabilitetit në nivel vendor dhe përgatitja e paketës së masave për trajtimin e tyre.**

Në kuadër të këtij nën-objektivi MFE në mënyrë të vazhdueshme ofron trajnime dhe mentorim për të gjitha zyrat përkatëse në nivel vendor duke dhënë asistencën e duhur dhe në të njëjtën kohë duke reflektuar edhe standardizimet e nevojshme me udhëzuesit për implementimin e buxhetit përkatës. Gjithashtu duhet të theksohet se nën-objektivi B5 ka dhe 2 aktivitete të tjera të cilat nuk kanë patur asnjë veprim gjatë vitit 2020 sipas raportimit të MFE. Këto nën-objektiva të cilat nuk kanë patur rezultate kanë të bëjnë me:


B5.3 Zbatimi i Sistemit të Informacionit Financiar të Qeverisë (Thesarit) në nivel vendor

B5.4 Zgjerimi i reformës së Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Auditimin e Brendshëm, Auditimin e Jashtëm etj., në nivel vendor

**4.3. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik C:**

Objektivi specifik “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor” përbëhet nga 3 nën-objektiva dhe 20 aktivitete të cilat zbërthehen më tej në masa. Ky objektivi specifik është një ndër objektivat më kompleks duke përfshirë shumë institucione përgjegjëse. Nga raportimi rezulton që në të gjithë nën-objektivat dhe aktivitetet ka patur hapa konkrete në realizimin e tyre, ndërsa në nivel mase ka patur raportim në 60% prej tyre. Gjithsesi, duhet specifikuar se shkalla e raportimit jo domosdoshmërisht përputhet me masën e realizimit.

**Grafiku 8:** Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik C





### **C1.1. Harmonizimi i kuadrit ligjor e rregullator për shërbimin e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura (Ligji për sektorin e ujit)**

Objektivi specifik C “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor” është një ndër objektivat më gjithëpërfshirës përse i përket ministrive të linjës dhe institucioneve qendrore. Ky objektivi përfshin të gjitha funksionet e pushtetit vendor, si nga këndvështrimi ligjor (harmonizimi ligjor), ashtu edhe nga ana administrative dhe funksionale. Së pari, aktiviteti C1.1 përfshin harmonizimin e kuadrit ligjor e rregullator për shërbimin e furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të ndotura (Ligji për sektorin e ujit). Institucioni përgjegjës mbi këto masa është MIE, ndërsa institucionet kontribuuese janë MB/AMVV, MFE, ERRU, ashtu edhe partner zhvillimi që punojnë në këtë sektor. Masat e këtij nën-objektivi përfshin:

- a) Rishikimin e kuadrit ligjor në lidhje me kompetencat rregullatore të NJVV për administrimin e plotë të ndërmarrjeve në pronësi dhe korrigjimi i mbivendosjeve ligjore në kompetencat mbikëqyrëse e vendosjen e standardeve midis AKUKM dhe ERRU;
- b) Përcaktimin e standardit minimal të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të furnizimit me ujë dhe kostimi i tij;
- c) Hartimin e studimeve të riorganizimit të mundshëm të SH.A. UK-ve për rritjen e efikasitetit.

Në kuadër të aktivitetit C1.1, masa a), MIE ka raportuar mbi aktet ligjore për hartimin e ligjit për sektorin e Ujësllës-Kanalizime. Projektligji nuk parashikon krijimin e ndonjë institucioni të ri publik në nivel qendror apo vendor që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në sektorin e furnizimit me ujë dhe grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane. Për këtë arsye ky projekt-ligji nuk pritet që të ketë ndonjë ndikim në rritjen e shpenzimeve buxhetore për NJVV. Shpenzimet që buxheti i shtetit ka bërë për financimin e projekteve të ndryshme në ndërtimin e ujësllësve ose të infrastrukturës së trajtimit të ujërave të ndotura urbane do të vijojnë të bëhen në përputhje me planet dhe strategjinë e qeverisë për sektorin. MIE raporton se janë zbatuar aktet ligjore në fuqi për hartimin e ligjit për sektorin e Ujësllës Kanalizime. Gjatë hartimit të projektligjit janë zhvilluar takime me institucionet si Agjencia Kombëtare e Ujësllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), Enti Rregullator i Ujit (ERRU), Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), Shoqata e Bashkive, Shoqata e Ujësllës-Kanalizimeve (SHUKALB), takime të ndara në 4 rajone me Shoqëritë e Ujësllës-Kanalizimeve dhe bashkitë përkatëse. Lidhur me problematikat e hasura, MIE nuk raporton ndonjë problematikë specifike, ndërsa për shkak të kompleksitetit të çështjes e vlerëson zbatimin e këtij aktiviteti me një risk të mesëm.

Në kuadër të aktivitetit C1.1, masa b), MIE gjatë periudhës janar-dhjetor 2020 është miratuar vendimi i Këshillit të Ministrave mbi rregullat teknike. Sidoqoftë, referuar këtij aktiviteti, vihet re se ai përfshin përcaktimin e standardit minimal të cilësisë dhe sigurisë së shërbimit të furnizimit me ujë dhe kostimi i tij, ndërsa vendimi i Këshillit të Ministrave në fjalë i referohet rregullave teknike dhe jo standardit minimal të shërbimit të furnizimit me ujë.

Duke kaluar tek masa c), MIE ka raportuar vetëm një lidhje me masën e dytë, ku thekson se masa e “Përcaktimit të nxitësve financiarë konkretë për riorganizimin strukturor të ndërmarrjeve dhe buxhetimi i planeve të riorganizimit” ka lidhje me reformën e ujit. Ndërsa, për dy masat e tjera “Përcaktimi i mekanizmave të përshtatshme për riorganizimin e shërbimeve në ndërmarrje më të mëdha, përfshirë modalitetet e bashkëpunimit ndërinstucional në nivel vendor” dhe “Konsultimi me NJVV-ve, MIE dhe ERRU për planet e organizimit” nuk ka raportim për vitin 2020, ndërsa vihet re

që afati i parashikuar i zbatimit të kësaj mase shtrihet deri në 2022. Lidhur me riskun, nuk ka raportim nga MIE, por ka risaktësim të vlerës financiare të Reformës së Ujit në vlerën 33,518,364 lekë nga buxheti i shtetit.

### **C1.2 Rimëkëmbja financiare e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura**

Duke vazhduar me sektorin e ujit, aktiviteti C1.2 fokusohet në rimëkëmbjen financiare të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura. Në të njëjtën linjë përgjegjësie si aktiviteti C1.1, edhe ky aktivitetet ka si institucion përgjegjës MIE. Gjithashtu, FZSHS shtohet si institucion përgjegjës në disa prej masave, sipas fushës së përgjegjësisë. Ndërsa, institucionet kontribuuese janë MB/AMVV dhe MFE. Në kuadër të aktivitetit C1.2, masat e përfshira janë:

- a) Rritja e subvencioneve për operimin e shërbimit për të mbuluar hendekun financiar për NJVV-të
- b) Vlerësimi i mundësisë së aplikimit nga UK si konsumatorë të kualifikuar për efekt të furnizimit me energji për operimin e shërbimit
- c) Përcaktimi dhe buxhetimi i financimeve për investime në nivel vendor nga buxheti i shtetit për arritjen e standardit minimal
- ç) Rishikimi i kriterëve për shpërndarjen e granteve me bazë performancën për rritjen e cilësisë së shërbimit
- d) Asistencë teknike për NJVV-të për hartimin e planeve të biznesit dhe aplikimin për rishikimin e tarifave të ujit.

Lidhur me aktivitetin e parë, C1.2, masa a, MIE ka raportuar Udhëzimin Nr.3 datë 18.06.2020 të Ministrit të MIE "Për miratimin e metodologjisë për kriteret dhe procedurat për shpërndarjen e subvencioneve shtetërore për shoqëritë aksionere të ujësjellës kanalizimeve për vitin buxhetor 2020 dhe 2021". Në këtë kuadër, sipas raportimit, ky aktivitet në periudhën janar-dhjetor 2020 është realizuar në masën 100%.

Në kuadër të aktivitetit C1.2, masa b, MIE ka raportuar përpjekje për mundësinë e tarifimit preferencial për Sh.A UK, si një ent publik i cili kryen një shërbim jetik për qytetarët, për të bërë të mundur që në të ardhmen të ulen kostot për këtë shërbim dhe të kryen pagesat korente të energjisë (si rasti për furrat e bukës). Gjithsesi, nuk ka një vlerësim të konkluduar lidhur me vlerësimin/studimin e mundësisë së aplikimit nga UK si konsumatorë të kualifikuar për efekt të furnizimit me energji për operimin e shërbimit.

Në kuadër të aktivitetit C1.2, masa c, MIE ka planifikuar financime nga buxheti i shtetit dhe financim të huaj sipas PBA dhe Buxhetit vjetor 2020 të MIE për infrastrukturën e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Duke kaluar tek dy masat në vijim, aktivitetet ç dhe d, MIE nuk ka raportuar për vitin 2020, edhe pse afati i zbatimit është deri në vitin 2022.

Meqenëse aktiviteti C1.2 konsiderohet një aktiviteti me përgjegjësi të ndarë ndërmjet MIE dhe FSHZH, Fondi raporton se kontribute në sektorin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime përmes zbatimit të Programit "Mbështetje për Sistemin e Furnizimit me Ujë në disa zona rurale". Gjithsesi, FSHZH arsyeton se MIE ka fushë përgjegjësi direkte në këtë drejtim.

### **C1.3 Qartësimi dhe financimi i përpjesshëm i kompetencave vendore në trajtimin e ujërave, menaxhimin e burimeve ujore dhe sigurinë e digave**

Në vijim, aktiviteti C1.3 “Qartësimi dhe financimi i përpjesshëm i kompetencave vendore në trajtimin e ujërave, menaxhimin e burimeve ujore dhe sigurinë e digave” përbën një ndër problematikat e evidentuara në Rishikimin Afatmesëm të Strategjisë për vitet 2015-2018. Kësisoj, problematikat e menaxhimit të burimeve ujore dhe sigurisë së digave vazhdojnë të konsiderohen si prioritete nga këndvështrimi i menaxhimit të tyre nga NJVV dhe institucionet qendrore. Institucionet përgjegjës mbi këto masa janë AMBU, MBZHR, dhe MIE, ndërsa institucionet kontribuuese janë: MB/AMVV dhe MFE.

Në kuadër të aktivitetit, masat e përfshira janë:

- a) Asistencë teknike për NJVV-të për rishikimin e tarifave të ujit të përdorur.
- b) Përcaktimi i qartë i kompetencave vendore në menaxhimin e burimeve ujore dhe mënyrës së financimit.
- c) Rritja e kompetencave monitoruese dhe zbatuese të NJVV-ve për menaxhimin e burimeve ujore.
- ç) Hartimi i raportit për kostimin e funksionit të mbikëqyrjes së sigurisë së digave dhe mbulimi i këtyre kostove për çdo NJVV.

Lidhur me masën a), MBZHR raporton se përsa i përket tarifave janë cituar në nenin 18 të ligjit nr.24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”, gjithashtu në funksion të llogaritjes së tarifave për shërbimin e ujitjes dhe të kullimit janë dhe dy akte nënligjore si Udhëzimi nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit” dhe Urdhri nr. 697, datë 30.12.2019 “Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit”.

Lidhur me masën b) është bërë një përcaktim i qartë i kompetencave, ku menaxhimi i burimeve ujore në nivel vendor bëhet nga ZABU (degët territoriale të AMBU-së), ndërsa kompetencat vendimmarrëse për dhënien e autorizimeve dhe lejeve për shfrytëzimin e burimeve ujore (në nivel baseni) i gëzon Këshilli i Basenit Ujor (KBU) përkatës. Siç parashikohet nga VKM Nr. 696, datë 30.10.2019, ‘Për përcaktimin e kufijve territorial, hidrografike të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe të qendrës e përbërjes së këshillit të secilit prej tyre’ në krye të KBU-së është prefekti i qarkut ku ndodhet qendra e basenit ujor dhe të gjithë bashkitë që ndodhen brenda territorit të basenit kanë nga një anëtar në KBU, që përkthehet në një votë në vendimmarrje

Lidhur me masën c), menaxhimi i burimeve ujore në vendin tonë bëhet bazuar në dispozitat e Liqjit Nr. 111/2012, ‘Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore’(i azhurnuar me Ligjin Nr.6/2018), ku përcaktohet qartë se kompetencën për menaxhimin e burimeve ujore e ka **AMBU**, në nivel kombëtar dhe degët e saj rajonale për basenet përkatëse, NJVV-të nuk kanë kompetencë të drejtpërdrejtë në menaxhimin e burimeve ujore. Në ligj janë specifikuar në mënyrë shteruese rastet kur parashikohet bashkëpunimi i AMBU-së me NJVV, si për shembull, për:

- zhvillimin e kontrolleve të rregullta të cilësisë së ujit të furnizuar (Neni 31);
- dhënien e lejeve për zhvillimin e veprimtarive ndërtimore në brigje (Neni 64);
- parandalimin, përballimin dhe për rehabilitimin e gjendjes së shkakuar nga përmytjet (Neni 68);

- instalimin e pajisjeve dhe servituteve të nevojshme për mbajtjen nën kontroll dhe matjen e sasisë së përdorimit të ujit (Neni 72);
- gjithashtu, NJVV janë ndër institucionet që ngarkohen me përgjegjësi për marrjen e masave dhe zbatimin e dispozitave të ligjit Nr. 111/2012, gjithmonë duke qënë nën menaxhimin e përgjithshëm të AMBU-së.

Sa më sipër, për pikën c menaxhimi dhe monitorimi i burimeve ujore në nivel vendor bëhet nga ZABU (degët rajonale të AMBU-së) jo nga NJVV, si rrjedhim nuk ka ndryshim në aspektin e rritjes së kompetencave të NJVV-ve për menaxhimin e burimeve ujore.

Në kuadër të aktivitetit C1.3, masa ç, MBZHR ka realizuar një llogaritje mbi e kostove të ndërhyrjeve kryesore në infrastrukturën e ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmytja dhe sigurinë e digave, për të gjitha fazat kryesore (studim fizibiliteti-projekt zbatimi-punime civile) të 4 projekteve madhore, ku me prioriteti, është ai lidhur me sigurinë e digave me një kosto totale 171 milion euro. Implementimi i këtyre projekteve, krahas kontributit modest të buxhetit të shtetit (çdo vit shpenzime dhe investime për infrastrukturën e ujitjes dhe të kullimit për MBZHR dhe direkt për bashkitë), kërkon edhe sigurimin e burimeve financiare nga institucione të ndryshme financiare për realizimin e plotë të tyre.

#### **C1.4 Rritja e cilësisë dhe eficiencës së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve**

Në vijim, aktiviteti C1.4 "Rritja e cilësisë dhe eficiencës së shërbimit të menaxhimit të integruar të mbetjeve", ku institucionet përgjegjës mbi këto aktivitete janë MIE dhe MTM, masat janë si më poshtë vijon:

- a) Asistencë teknike për NJVV-të për zbatimin e VKM nr.319, datë 31.5.2018 "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve"
- b) Hartim i studimeve/planeve me qëllim zbatimin e objektivave të përcaktuar në dokumentet strategjike në fushën e mbetjeve
- c) Asistencë teknike për qartësimin dhe negocimin e marrëdhënieve kontraktuale të NJVV-ve me qeverinë qendrore dhe impiantet e trajtimit të mbetjeve
- ç) Ndërtimi i impianteve të trajtimit të mbetjeve në përputhje me masterplanin kombëtar
- d) Vlerësim dhe shqyrtim i planeve të përmirësimit nga institucionet përgjegjës të përcaktuar në VKM nr. 452, datë 11.7.2012, "Për lëndfilltet e mbetjeve", i ndryshuar
- dh) Asistencë teknike dhe financiare për NJVV për ofrimin e shërbimeve sipas standardeve, përfshirë edhe mbledhjen e diferencuar dhe riciklimin
- e) Përcaktimi i standardeve kombëtare minimale dhe asistencë për arritjen e tyre.

Në kuadër të aktivitetit C1.4, masa ç, MIE ka raportuar ndërtimin e lëndfillit rajonal të Vlorës (Sherishte), i cili është realizuar në 1.3% pasi kjo masë fillon nga viti 2021 dhe mbaron në vitin 2022. Në kuadër të aktivitetit C1.4, masa a, b, c, d, dh, e, MIE dhe MTM nuk kanë raportuar, ndërkohë që vihet re që afati i zbatimit është deri në vitin 2022.

Në kuadër të këtyre masave, raportim ka patur nga donatorët të cilët kanë patur përfshirje të drejtpërdrejtë në këto masa. Më konkretisht projekti BtF gjatë 2020 ka patur ndërhyrje në disa nga masat e lidhura me këtë nën-objektiv.

Sa i përket masës "a", është mbështetur ngritjen e një help desk pranë MTM për zbatimin e VKM 319/2018. Në kuadër të kësaj asistence, gjatë vitit 2020 për herë të parë 21 bashki të tjera, kanë aplikuar modelin e llogaritjes së kostos konform kësaj VKM.

Lidhur me masën b, në vitin 2020 kanë përfunduar edhe 4 plane të tjera lokale të menaxhimit të mbetjeve në Kurbin, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës dhe Mirditë duke plotësuar me plane lokale të menaxhimit të mbetjeve 18 bashki.

Lidhur me masën c, në vitin 2020 është përfunduar studimi për operacionilzimin e MasterPlanit në zonën e mbetjeve Shkodër-Lezhe. Si vijim i këtij studimi, është përfunduar modeli i llogaritjes së kostos operacionale të landfillit të Bushatit, mbi bazën e së cilës është vendosur tarifa e depozitimit.

### **C1.5 Rishikimi i funksionit të transportit rrugor për rritjen e efijencës**

Lidhur me aktivitetin C1.5 "Rishikimi i funksionit të transportit rrugor për rritjen e efijencës" vihet re se raportimi nga MIE mungon. Edhe pse ky aktivitet ka një afat deri në 2022, sërish rishikimi i funksionit të transportit rrugor për rritjen e efijencës është një problematikë e ngritur edhe në raporte të tjera të monitorimit. Referuar Planit të Veprimit, ky nënobjektiv përfshin masat si më poshtë vijon:

- a) Rishikimi i roleve të këshillit dhe kryetari në përcaktimin e organizimit të transportit qytetas dhe ndërqytetës në përputhje me kompetencat përkatëse kuadër të secilit organ
- b) Rishikimi i ligjit për transportet rrugore dhe përcaktimi i autoritetit rregullator dhe monitorues të NJVV-ve
- c) Përgatitja e kuadrit rregullator për kompensimin e tarifave të transportit publik për kategori të veçanta

### **C1.6 Forcimi i kompetencave rregullatorë dhe administrative të NJVV në fushën e mbrojtjes së mjedisit**

Në vijim, C1.6 "Forcimi i kompetencave rregullatorë dhe administrative të NJVV në fushën e mbrojtjes së mjedisit" fokusohet në funksionin e mbrojtjes së mjedisit deleguar NJVV në vitin 2015. Institucionet përgjegjës kryesore për këtë aktivitet është MTM dhe AKP, ndërsa për një aktivitetet specifik ASPA. Nga ana tjetër MB/AMVV është institucion kontribuues, ku në këtë rast ka të bëjë më koordinimin me NJVV. Masat e përfshirja janë:

- a) Rishikim i bazës ligjore për lejet e mjedisit për të përcaktuar përgjegjësitë dhe kompetencat bashkiake rregullatorë dhe monitoruese për aktivitetet industriale që kanë një ndikim relativisht të ulët në mjedis dhe që zhvillohen në zona urbane, jashtë zonave industriale
- b) Rishikimi i kompetencës bashkiake për monitorim dhe sanksione administrative direkte lidhur me mbrojtjen e mjedisit
- c) Qartësimi i kompetencës vendore në fushën e mbrojtjes nga ndotja e ajrit, ujit dhe akustike
- ç) Asistencë teknike dhe rritje kapacitetesh për planet vendore të veprimit për mjedisin dhe strukturat përkatëse
- d) Asistencë teknike dhe rritje kapacitetesh për mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi

dh) Krijimi i një modeli menaxhimi për Mjedisin dhe trajnimi i administratës së NJVV

Lidhur me masat më sipër, MTM dhe AKP nuk kanë raportuar. Gjithsesi, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr.101, datë 03.07.2021, vihet re që MTM ka kaluar një sërë aktesh nënligjore përgjegjësitë dhe kompetencat bashkiake rregullatorë dhe monitoruese për aktivitetet industriale që kanë një ndikim relativisht të ulët në mjedis dhe që zhvillohen në zona urbane, jashtë zonave industriale, ashtu edhe kompetencat bashkiake për monitorim dhe sanksione administrative direkte lidhur me mbrojtjen e mjedisit. Lidhur me masat e tjera, nevojitet raportimi i MTM për të përcaktuar progresin e bërë.

### **C1.7 Rritja e efikasitetit të shërbimeve vendore në bujqësi, zhvillim rural, pyje dhe kullota**

Duke kaluar tek C1.7 “Rritja e efikasitetit të shërbimeve vendore në bujqësi, zhvillim rural, pyje dhe kullota”, shihet se sërish MBZHR dhe MTM janë institucione përgjegjëse për aktivitetet më poshtë sipas fushës së tyre të përgjegjësisë:

- a) Rishikimi i ndarjes së kompetencave për mbrojtjen dhe administrimin e tokës mes qarkut dhe bashkive
- b) Mbështetje me asistencë teknike dhe financime për hartimin e planeve të reja të menaxhimit të pyjeve e kullotave në nivel vendor
- c) Dhënia e kompetencave për sanksione administrative direkte për bashkitë në lidhje me shkelje në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e pyjeve e kullotave
- d) Përcaktimi i kompetencave të NJVV-ve në informacionin dhe këshillimin bujqësor

Gjithsesi, ky është një objektivi për të cilin asnjë nga institucionet nuk kanë raportuar. Duke iu referuar mbledhjeve të Këshillit Konsultativ, konstatohet se në fakt MTM ka konsultuar me NJVV disa projektvendime të cilat lidhen me kompetencat e këtyre të fundit në fushën e informacionit dhe këshillimit bujqësor.

### **C1.8 Rritja e efikasitetit në administrimin e rrjeteve të ujitjes e kullimit**

Një ndër funksionet kryesore të deleguara në 2015 pushtetit vendor në fushën ujitjes është edhe ai i administrimit të rrjeteve të ujitjes dhe kullimit, që reflektohet tek aktiviteti C1.8 “Rritja e efikasitetit në administrimin e rrjeteve të ujitjes e kullimit”. Masat që përfshihen në këtë aktivitet janë si më poshtë:

- a) Plotësimi i kuadrit nënligjor
- b) Financimi nga buxheti i shtetit i investimeve në infrastrukturën e ujitjes dhe kullimit dhe sigurisë së digave

Institucionet përgjegjëse mbi këto masa janë: MBZHR dhe MFE, ndërsa institucionet kontribuuese janë MB/AMVV dhe NJVV.

Në kuadër të aktivitetit C1.8, masa e parë, MBZHR ka raportuar aktet nënligjore të miratuara në vitin 2019 si më poshtë:

- Urdhri nr. 370, datë 11.6.2019 “Për miratimin e statutit tip të Organizatës së Përdoruesve të Ujit”.

- Urdhri nr. 535, datë 27.9.2019 “Për miratimin e marrëveshjes tip të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor.
- Udhëzimin nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”.
- Urdhri nr. 697, datë 30.12.2019 “Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit”
- Gjithashtu me VKM nr. 345, datë 22.5.2019, është miratuar Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe të Kullimit 2019 – 2031.

Duke kaluar tek masa e dytë, MBZHR ka paraqitur Investime për bashkitë për vitin 2020, dhe parashikimi për vitin 2021. Sidoqoftë, MBZHR thekson se ndër problemet që duhet të adresohet me përparësi është siguria e digave të rezervuarëve të ujitjes që administrohen nga bashkitë, kjo për faktin se:

- Digat e rezervuarëve për ujitje janë të ndërtuara kryesisht në periudhën 1960 – 1989, dhe pothuajse kanë plotësuar apo po plotësojnë afatin e shfrytëzimit të tyre dhe gjatë 20 viteve të fundit, mirëmbajtja e tyre është larg parametrave optimalë.
- Nga vlerësimet e bëra, rezulton se digat janë në gjendje teknike të vështirë, me probleme të ndryshme teknike (kryesisht në trupin e digës, shkarkuesin katastrofik, ujëlëshuesin, etj.) dhe ndërhyrjet rehabilituese në një pjesë të konsiderueshme janë një domosdoshmëri imediate.
- Megjithëse këto diga me ujëmbledhësit e tyre kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e bujqësisë, në rrethana të caktuara, në rast prishje eventuale të tyre, ato mund të kthehen në burim fatkeqësish, me pasoja për jetë njerëzish dhe dëme të mëdha ekonomike, kjo edhe për faktin se në anën e poshtme të një pjesë të digave, aktualisht ka të ndërtuara shtëpi banimi apo objekte për veprimtari ekonomike, që nuk kanë qenë të parashikuara në fazën e projektimit dhe ndërtimit të digave. Për rrjedhojë, këto diga nuk kanë sigurinë e duhur për mbrojtjen e këtyre qendrave të banuara.
- Edhe transferimi i përgjegjësisë të operimit dhe mirëmbajtjes së digave tek bashkitë, përgjithësisht nuk ka sjellë ndonjë përmirësim të dukshëm përse i përket sigurisë së digave, madje në disa raste, përkujdesi i bashkive është fare minimal.

Garantimi i sigurisë së digave, është një kërkesë e dispozitave të ligjit nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, dhe VKM nr. 147, datë 18.3.2004, “Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave”, si dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga MBZHR si Udhëzimi nr. 12, datë 30.12.2019 “Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit” (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 189, viti 2019) dhe Urdhri nr. 697, datë 30.12.2019 “Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit” (botuar në Fletoren Zyrtare nr. 190, viti 2019).

Në këtë kontekst, MBZHR nisur nga aktiviteti i deritanishëm i bashkive në lidhje me sigurinë e digave, gjykon, që prioritet duhet të jenë:

- Krijimi/konsolidimi pranë çdo bashkie i grupit përgjegjës për ruajtjen dhe monitorimin e sigurisë së digave (me stafin përkatës inxhinierë dhe teknike dedikuar sigurisë së digave),

evidentimi nga bashkitë të problematikave për çdo dige, mbajtja nën monitorim të digave me probleme dhe mosmbushja me ujë e digave, që i çenohet siguria, prioritetizimi i ndërhyrjeve për sigurinë e digave, duke i paraprirë procesit me hartimin e projekteve të zbatimit dhe implementimit të tyre me burime të ndryshme financimi;

- Trajnimi i stafit që mbulon monitorimin e sigurisë së digave, sipas përcaktimeve në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Grantet e pakushtëzuara, që i planifikohen çdo vit bashkive, investimet për rehabilitimin e digave, të kenë prioritet dhe të jenë zë më vetë në buxhetin e detajuar të bashkive.

### **C1.9 Mbështetje për NJVV-të për ushtrimin e funksioneve të lidhura me sigurinë publike**

Në vijim, aktiviteti i fundit i objektivit specifik C1.9, është mbështetja për NJVV-të për ushtrimin e funksioneve të lidhura me sigurinë publike. MB dhe AMVV janë institucionet përgjegjëse për këtë nënobjektiv, i cili përfshin aktivitetet si më poshtë:

- a) Programi për mbështetjen e MZSH në nivel vendor
- b) Qartësimi i rregullimit të funksionit MZSH vendore
- c) Rishikimi/forcimi i kompetencave të policisë bashkiake

Lidhur me këtë aktivitet, MB dhe AMVV raportojnë se janë një sërë masash të ndërmarra në kuadër të plotësimit të tre masave më lart. Më konkretisht, lidhur me MZSH, raportohet se të gjitha ndryshimet nënligjore, në përputhje me Urdhrin e Kryeministrit nr.101, datë 03.07.2021 për harmonizimin ligjor të funksioneve të deleguara tek pushteti vendor, shërbejnë drejtpërsëdrejti në qartësimin e funksionit MZSH në nivel bashkie.

Së dyti, lidhur me policinë bashkiake, MB/AMVV raporton se puna për hartimin e projektligjit “Për Policinë Bashkiake” ka nisur që në 2019 dhe është konkluduar me një draft. Sidoqoftë, MB/AMVV janë në proces rishikimi final të këtij projektligji me qëllim kalimin e tij në Këshill të Ministrave në tremujorin e fundit të 2021. Për vitin 2020 raportohet vetëm studimi dhe finalizimi i tij në një draft projektligj, i cili është në fazën e dytë të rishikimit.

### **C1.10 Rritja e efikasitetit për ofrimin e shërbimeve sociale**

Lidhur me MSHMS, aktiviteti C1.10 “Rritja e efikasitetit për ofrimin e shërbimeve sociale” elaboron në detaje aktivitetet që lidhen me shërbimin social deleguar bashkive në vitin 2015. Masat që përfshihen janë si më poshtë:

- a) Hartimi dhe miratimi i standardeve të shërbimeve dhe kostove për njësi
- b) Ngritja e kapaciteteve të NJVV-ve për planifikimin e shërbimeve sociale (duke përfshirë identifikimin, menaxhimin, monitorimin dhe vlerësimin e sistemit të shërbimeve sociale)
- c) Plotësimi i paketës rregullatorë për mënyrën e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror
- d) Rishikimi i skemës së jashtë kontraktimit dhe prokurimit të shërbimeve të kujdesit social nga NJVV-të
- e) Plotësimi i kuadrit nënligjor për ligjin e strehimit social



- f) Financimi në rritje për skemat e strehimit social (përfshirë investime)
- g) Konsolidimi dhe përdorimi i sistemit të integruar të informacioni për përfituesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror në të gjitha nivelet
- h) Rishikimi i ligjit për shërbimet sociale për të siguruar efikasitet më të lartë të procedurave vendimmarrëse brenda NJVV për menaxhimin e shërbimeve sociale (neni 28)

Përveç MSHMS, në disa prej zërave kërkohet edhe ndërhyrja e MFE dhe MB/AMVV. Në kuadër të aktivitetit C1.10, masa e parë, MSHMS ka raportuar numri i standardeve të hartuara, të cilat janë më konkretisht standardet e shërbimit të emergjencës së sigurt, standardet për ri-integrimin e viktimave të trafikimit, si dhe të shërbimit lëvizës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Në kuadër të aktivitetit C1.10, masa e dytë, MSHMS, në kuadër të shtrirjes së Regjistrimit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore janë kryer takime informuese dhe trajnime me administratorët shoqërorë/ të qarqeve Elbasan, Tiranë, Shkodër, Fier, Vlorë, Korçë (sipas Analizës vjetore të SHSSH), ashtu edhe mbi shëndetin mendor dhe mbështetjen psiko-sociale në raste emergjencash, mbi menaxhimin e rastit për të kthyerit nga zonat e luftës, mbi mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve (në bashkëpunim me ASPA), personat me aftësi të kufizuara, etj.

Në këtë kuadër një tjetër raport kombëtar mbi shërbimet sociale të ofruara nga bashkitë për dhunën në familje gjatë periudhës së pandemisë COVID 19 u hartua me mbështetjen e projektit BtF.

Në kuadër të aktivitetit C1.10, masa e tretë, MSHMS ka raportuar se kjo masë është parashikuar të fillojë në gjashtëmuorin e dytë të 2021, me mbështetjen e partnerëve të zhvillimit (UNICEF).

Në kuadër të aktivitetit C1.10, masa e katërt, MSHMS ka informuar se ligji i ri i prokurimeve u miratua në dhjetor 2020 dhe nuk ka filluar ende hartimi i akteve nënligjore, përfshirë këtu dhe aktet rregullatorë për mënyrën e financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat do të hartohen nga Agjencia e Prokurimeve në bashkëpunim me MSHMS.

Ndërsa, lidhur me masën ç, MSHMS thekson se për periudhën korrik-dhjetor 2020 u trajnuan të gjitha stafet sociale në nivel vendor mbi përdorimin e regjistrimit MIS, on-job-training ku dhe filloi procesi i hedhjes së të dhënave, proces i realizuar me financimin e partnerëve të zhvillimit (UNICEF).

Në kuadër të aktivitetit C1.10, masa d, MFE ka raportuar aktet nënligjore të miratuara kundrejt totalit të plotësisht të paketës me akte nënligjore të ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social", në total ky objektiv është realizuar rreth 90% pasi zbatimi i tij ka filluar që në vitin 2018 me hyrjen e ligjit të ri në fuqi.

Në kuadër të aktivitetit C1.10, masa dh, MFE ka paraqitur Raportin e buxhetit të shtetit për strehimin kundrejt Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), i cili është 0.038% e PBB. Deri në vitin 2022 synohet që buxheti i shtetit për strehim të jetë në masën 0.04% të PBB. Ndërsa, vihet re se për vitin 2020, nuk janë përfshirë fondet e alokuara për subvencionimin e qirasë për familjet e prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019.

### **C1.11 Rritja e efikasitetit për ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit**

Aktiviteti C1.11 "Rritja e efikasitetit për ofrimin e shërbimeve në fushën e arsimit" përfshin masat si më poshtë:

- a) Qartësimi i kompetencave administrative të NJVV në administrimin e arsimit parashkollor
- b) Krijimi i një sistemi të ndërsjellë shkëmbimi të dhënash midis MASR/Institucioni Arsimor Vendor, MFE dhe NJVV-ve, mbi regjistrimin dhe frekuentimin e fëmijëve në kopshte e nxënësve në shkolla
- c) Rregullimi i ofrimit të transportit të fëmijëve dhe mësuesve nëpërmjet NJVV-ve
- d) Ngritja e skemës së financimit të mirëmbajtjes së vazhdueshme dhe investimeve në sistemin shkollor parauniversitar nga buxheti i shtetit, në harmoni me parimet e autonomisë vendore
- e) Ngritja e një skeme financimi për pajisjen e kopshteve me materiale didaktike për fëmijët
- f) Shqyrtimi i mundësisë së financimit të një programi universal/kombëtar për ofrimin e ushqimit në arsimin parashkollor për përmirësimin e cilësisë dhe aksesit në kopshte, zbutjen e varfërisë dhe rritjen e përfshirjes dhe kohezionit social
- g) Hartimi i planeve për menaxhimin e arsimit parashkollor
- h) Rishikimi i kompetencave administrative të NJVV në administrimin e arsimit para-auniversitar krahas konsolidimit të Shkollës së Drejtorëve dhe Portalit të Mësuesve

MASR, si institucioni përgjegjës në këtë fushë, ka raportuar vetëm për masat c, ç dhe d. Më konkretisht, lidhur me masën c, MASR ka raportuar se ky shërbim aktualisht ofrohet nga MASR përmes Drejtorive Rajonale Arsimore. Ky funksion u delegua tek NJVV në vitin 2016 dhe në vitin 2018 u rikthye përsëri për shkak të moseficensës. Gjithsesi, MASR gjykon se lidhur me këtë çështje nevojiten studime më të thelluara sektoriale me qëllim vendimmarrjen e mirëinformuar dhe një bashkëpunim i ngushtë mes ZVAP dhe NJVV.

Lidhur me pikën vijuese, MASR raporton se duhet një koordinim me MFE që për mirëmbajtjen e objekteve shkollore të dedikohet një transfertë specifike, në formë granti i kushtëzuar, i cili të përdoret vetëm për këtë deshtinacion. Së fundmi, lidhur me masën d, MASR ka raportuar se furnizimi me materiale didaktike për kopshtet është në nivel qendror, duke shënuar vitin e katërt të këtij shërbimit të MASR, e më specifikisht janë përdorur rreth 100 milion lekë për periudhën 2018-2021.

Përsa i përket masave të tjera ka patur disa rezultate me mbështetjen e donatorëve. Më konkretisht me mbështetjen e BtF është hartuar "Manuali për profesionistët", i cili qartëson kompetencat administrative të NJVV dhe të nivelit kombëtar në administrimin e arsimit parashkollor. Lidhur me masën g, janë hartuar 6 plane për përmirësimin e menaxhimit të arsimit parashkollor të hartuara me mbështetjen e BtF në bashkitë: Shkodër, Kukës, Durrës, Ura Vajgurore, Vlorë dhe Korçë nga të cilat 5 aprovuar me vendim të këshillave bashkiake përkatës.

#### **C1.12 Rishikimi i legjislacionit sektorial për funksionet vendore në shërbimin shëndetësor**

Duke kaluar tek shërbimi shëndetësor, si një fushë tjetër përgjegjësie e MSHMS, aktiviteti C1.12 "Rishikimi i legjislacionit sektorial për funksionet vendore në shërbimin shëndetësor" përfshin aktivitetet si më poshtë:

- a) Zhvillimi i standardeve dhe kostove për njësi në shërbimin shëndetësor parësor
- b) Përcaktimi i qartë i kompetencave vendore për shëndetin publik dhe financimi i tyre

- c) Ngritja dhe konsolidimi i skemës së financimit për kompetencat e NJVV-ve në fushën e shëndetësisë, përfshirë mirëmbajtjen e godinave shëndetësore

Në kuadër të aktivitetit C1.12 , masa e parë, MSHMS ka raportuar se po realizohet vlerësimi i të gjitha standardeve/protokolle të shërbimit shëndetësor parësor për t'u integruar me atë social. Mbi bazën e këtij studimi do të bëhet rishikimi i standardeve/protokolleve ekzistuese ose hartimi i standardeve/protokolleve të reja.

Duke vazhduar me masën e dytë, MSHMS raporton se në vijim të ushtrimit të kompetencave të NJVV në fushën e shëndetit publik, gjatë vitit 2020 është mundësuar forcimi i kapaciteteve të stafëve të të gjitha niveleve të NJVV për përballim situatash emergjente si p.sh.. në situatën e emergjencës së krijuar nga tërmeti në vend ashtu edhe për përballimin dhe menaxhimin e situatës epidemiologjike si rezultat i pandemisë Covid-19.

Së treti, MSHMS ka raportuar mbi rritjen e rolit financues në fushën e mirëmbajtjes dhe investimeve në rikonstruksione të Qendrave Shëndetësorë/Ambulancave nëpërmjet pjesëmarrjes direkte të pushtetit vendor në kontribute financiare në ndërhyrjet e kryera dhe veçanërisht në ndërhyrjet për rikonstruksioneve të mbështetura nga burime të buxhetit të shtetit ashtu edhe partnerë zhvillimi.

### **C2.1 Forcimi i funksionit të zhvillimit ekonomik vendor**

Në kuadër të aktivitetit C2.1, masat e përfshira janë si më poshtë vijon:

- a) Hartimi i ndryshimeve ligjore sektoriale që fuqizojnë rolin e NJVV-ve për investimet strategjike, partneritetin publik-privat, menaxhimin e aseteve vendore etj.
- b) Asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh për shfrytëzimin e aseteve vendore për zhvillim ekonomik.
- c) Lehtësimi i procedurave të menaxhimit të pronës publike nga bashkia për zhvillim.

Institucionet përgjegjës mbi këto masa janë MB/AMVV, ndërsa MIE, MFE dhe NJVV janë institucione kontribuuese, e ndërsa është parashikuar edhe asistencë e partnerëve të zhvillimit. Sidoqoftë, masat në fjalë konsiderohen komplekse, të cilat kërkojnë studime të thelluara sektoriale me qëllim forcimin e funksionit të zhvillimit ekonomik vendor. Kësisoj, zbatimi i tyre është zhvendosur për vitin 2021-2022.

### **C2.2 Lehtësimi i procesit të transferimit të pronave publike tek NJVV për qëllim zhvillimi publik**

Në kuadër të aktivitetit C2.2, masat e përfshira janë:

- a) Ngritja e një task-force me pjesëmarrje të nivelit qendror dhe vendor për përshpejtimin e procesit të transferimit të pronave
- b) Krijimi i një sistemi të digjitalizuar integral në nivel kombëtar për regjistrat e pronave të transferuara në NJVV
- c) Asistencë teknike për NJVV për identifikimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e pronave për transferim

Institucioni përgjegjës mbi këto masa është ASHK, ndërsa institucione kontribuuese renditen MB/AMVV dhe NJVV, ndërkohë partnerë e zhvillimit kanë kontributin e tyre në këtë drejtim. Në kuadër të aktivitetit C2.2, masa, a, b, c, ASHK arsyeton se puna për transferimin e pronave publike tek NJVV është komplekse, jo vetëm për shkak të ndryshimeve territoriale, por mbi të gjitha për shkak të kompleksitetit të pronave në të gjithë bashkitë dhe metodologjisë së përdorur, një pjesë e kompleksitet ardhur edhe nga problematikat e transferimit ndër vite.

Së pari, nga pikëpamje metodologjike arsyetohet se identifikimi i pronave nuk bëhet në mënyrë individuale për çdo pronë, por në klasa pronash në bazë fshati. Duke qenë një informacion i përgjithshëm, pra jo për çdo pronë individuale, por për njësi pronash së bashku (të quajtura klasa), informacioni kryqëzohet me Ministritë e Linjës (p.sh. Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimi Rural), çka e bën edhe më kompleks dhe të ngadaltë procesin e transferimit. Së treti, për NJVV, transferimi shoqërohet me një kosto, çka duhet të merret parasysh nga buxheti i bashkive.

Procesit të transferimit të pronave i vjen në ndihmë disa ndryshime nënligjore që priten së shpejti të miratohen. Ndërsa, lidhur me masën e tretë “Asistencë teknike për NJVV për identifikimin, vlerësimin dhe rivlerësimin e pronave për transferim”, raportohet se kjo asistencë është e vazhdueshme ndaj pushtetit vendor. Procesi i transferimit të pronave në vetvete përfshin tre hapa: (i) procesin e inventarizimit (identifikimin e llojit të pronës shtet apo jo), (ii) procesin e transferimit dhe (iii) identifikimin dhe adresimin e problematikave të ndryshme (miratim i pronave për transferim tek NJVV).

ASHK raporton se për transferimin e pronave punohet me kërkesat e ardhura nga NJVV dhe në vitin 2020 janë miratuar 100% e kërkesave të ardhura. Patjetër që procesi ka qenë i gjatë, duke qenë se të gjitha kërkesat janë shoqëruar me problematika dhe verifikime të shumta nga ana e kësaj agjencie. ASHK bën verifikime dhe rregullon dokumentacionin për të gjitha kërkesat e ardhura.

Së fundmi, raportohet se gjatë vitit 2020 ka një sërë ndryshimesh ligjore që lidhen me transferimin e pronave, sikurse paraqitet tek tabela më poshtë:

**Tabela 2:** Vendime të Këshillit të Ministrave

Vendime të Këshillit të Ministrave për vitin 2020						
Institucioni Propozues	Numri i VKM	Numri i pronave të transferuara	Numri i pronave të transferuara në pronësi	Aksionet e Shoqërive të Trajtimit të Studenteve	Segmente rrugore	Pyje/ kullota dhe prona te bordeve te kullimit
ASHK	15	123	123			
Ministri të tjera	17	16	16	3	2	Shtesa dhe ndryshime ne VKM 433 dhe 4 Bordeve te Kullimit
<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>139</b>	<b>139</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	

### C2.3 Mbështetja për fuqizimin e strukturave të turizmit në nivelin vendor.

Në kuadër të aktivitetit C2.3, MTM ka raportuar se nëpërmjet Degëve Territoriale koordinon punën me strukturat e nivelit vendor të cilat janë ne 40 Bashki. Zhvillimi i agroturizmit vitit e fundit lind nevojën për rritjen e numrit te personave te kualifikuar për turizmin pranë çdo bashkie. Kryesisht

bashkitë e zonave verilindje e juglindje personel këshillues për subjektet. Institucioni përgjegjës mbi këtë aktivitet është MTM, ndërsa institucione kontribuuese janë MB/AMVV dhe MK.

#### **C2.4 Qartësimi i funksioneve e përgjegjësive në fushën e Trashëgimisë Kulturore. Rishikimi i kuadrit ligjor.**

Institucioni përgjegjës mbi aktivitetin C2.4 “Qartësimi i funksioneve e përgjegjësive në fushën e Trashëgimisë Kulturore. Rishikimi i kuadrit ligjor” është MK, ndërsa institucioni kontribuues është MB/AMVV, ashtu edhe vlerësohet edhe roli i partnerëve të zhvillimit. Në kuadër të aktivitetit C2.4, MK ka raportuar se numri i akteve të miratuara është në masën 57%.

#### **C2.5 Ngritja e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor**

Në kuadër të aktivitetit C2.5 “Ngritja e një sistemi të integruar të zhvillimit të zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore në nivel vendor”, MK, si institucion përgjegjës, ka raportuar realizimin e investimeve në masën 84.36%. Ndërsa, MTM konsiderohet institucion kontribuues.

#### **C2.6 Skema vendore për mbështetjen e bizneseve me grante apo shërbime të tjera**

Aktiviteti C2.6 “Skema vendore për mbështetjen e bizneseve me grante apo shërbime të tjera” përfshin vetëm masën (a) Asistencë teknike për NJVV. Institucioni përgjegjës mbi këtë masë është MFE, ndërsa institucionet kontribuuese janë MB/AMVV dhe NJVV, e ndërsa vlerësohet angazhimi i partnerëve të zhvillimit. Në kuadër të aktivitetit C2.6, masa, a, MFE nuk ka raportuar, edhe pse vërehet se këto masa kanë afatin e zbatimit deri në vitin 2022.

#### **C3.1 Vlerësim i Ligjit 139/2015 për të përforcuar konceptin e standardit minimal kombëtar sektorial**

Lidhur me dy aktivitetet e fundit, edhe pse nga rëndësia konsiderohen shumë të rëndësishëm, C3.1 “Vlerësim i Ligjit 139/2015 për të përforcuar konceptin e standardit minimal kombëtar sektorial” dhe C3.2 “Hartimi/përditësimi i standardeve minimale kombëtare për fushat prioritare”, MB është institucioni përgjegjës për koordinim me ministritë e linjës me qëllim hartimin dhe/ose nëse ka ekzistuese përditësimin e standardeve minimale kombëtare për fushat si më poshtë:

- a) MZSH
- b) Arsimit parauniversitar
- c) Shërbimet e pastrimit, gjelbërimit, etj.
- ç) Strehimit
- d) Sigurisë (Policia bashkiake)
- dh) Bujqësisë dhe zhvillimit rural
- e) Emergjencave Civile


Edhe pse MB/AMVV ka pasur përpjekje për fillimin e punës për hartimin e standardeve minimale, sipas grupit të punës ndërsektorial të ngritur në vitin 2019, por që funksionoi në 2020, raportohet se ky proces, për shkak të kompleksitetit në vetvete që shfaq, ashtu edhe natyrës ndërsektoriale, ka nevojë për prioritizimin të shërbimeve më lart, ashtu edhe studim të thelluar sektoriale. Ashtu, duhet përmendur që situata e pandemisë gjatë 2020 ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në vazhdimësinë e këtij grupi pune.

Ndër iniciativat e raportuara në këtë kuadër vlen të theksohet që në shkurt 2020, nën drejtimin e AMVV dhe me mbështetjen e BtF, u hartua raporti kombëtar mbi zbatueshmerinë e standardeve kombëtare në Arsimin Parashkollor në 60 bashki të vendit.

#### 4.4. Reforma të implementuara në kuadër të Objektivit Specifik D

Objektivi specifik “Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor” përbëhet nga 4 nën-objektiva dhe 19 aktivitete. Njëlloj si nënobjektiv C, edhe nënobjektiv D përfshin shumë institucione përgjegjëse, por ndryshe nga planet e tjera të veprimit, në rastin e decentralizimit përfshihen edhe NJVV. Nga raportimi rezulton që në 75% të nën-objektivit ka patur hapa konkrete në realizimin e tyre, ndërsa në nivel aktiviteti, raportimi shkon në 83%, e ndërsa në nivel mase ka patur raportim në 100% prej tyre. Gjithsesi, duhet specifikuar se shkalla e raportimit jo domosdoshmërisht përputhet me masën e realizimit.

**Grafiku 9:** Rezultatet e arrira për Objektivin Specifik D



Ndryshe nga Strategjitë e tjera që kërkojnë thjesht një koordinim në nivel ministrie linje dhe agjencish qendrore, SKNDQV përfshin edhe NJVV si aktorë shumë të rëndësishëm në zbatimin e Planit të Veprimit. Kështu, pjesa më e madhe e masave që parashikon angazhim të NJVV, më specifikisht bashkive, është nënobjektivi D1 “Sigurimi i një qeverisjeje të hapur, rritje të transparencës, llogaridhënies dhe shtrirje më të madhe të e-qeverisjes në nivel vendor”.

Ky nënobjektiv përfshin D1.1 “Rishikimi i procedurave të brendshme të NJVV në përputhje me Kodin e ri të Procedurave Administrative”, D1.2 “Përgatitja e një programi për rritjen e mundësisit të aksesit efektiv të qytetarëve në vendimmarrjen vendore dhe aktet normative vendore përmes botimit proaktiv dhe përdorimit të TIK”, D1.3 “Mbështetja e qeverisjes vendore për përdorimin e platformave

të informacionit publik” dhe D1.4 “Përdorimi i formave të informacionit dhe këshillimit publik për aspekte të financave publike dhe qeverisjes”.


Me qëllim matjen e zbatimit të këtij nënobjektivit nga ana e NJVV, AMVV ka marrë informacion nga bashkitë me anë të një pyetësi online dërguar, ashtu edhe ofrimin të sesioneve individuale informuese mbi mënyrën e plotësimit të pyetësit. Më konkretisht, për një periudhë 2 javore, janë përgjigjur 42 bashki nga 61 në total, përfshirë këtu kategori të ndryshme si nga madhësia ashtu edhe pozicioni gjeografik të bashkive.

Më konkretisht, lidhur me aktivitetin e parë, D1.1, bashkitë raportojnë më së shumti se janë marrë masa gjatë vitit 2020 për rishikimin e procedurave të brendshme të bashkisë në përputhje me Kodin e Ri të Procedurave Administrative. Kësisoj, gati gjysma e bashkive raportuese informojnë që ndër procedurat e brendshme të hartuara dhe/ose ndryshuara/rishikuara janë: (i) Plani i Menaxhimit të Mbetjeve (ii) Rregullorja e Këshillit (paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare), (iii) Rregullorja e Kodit të Sjelljes për Këshillin Bashkiak, (iv) Plani Social i Strehimit dhe Plani Social Vendor, (v) Rregullorja e Menaxhimit të Arkivave, (vi) Rregullorja për Ngritjen e Funkcionimin e Strukturave Komunitare në Bashki, etj.

Pjesa tjetër e bashkive ose raportojnë që kanë rishikuar një numër të kufizuar procedurash ose që nuk është bërë asnjë ndryshim lidhur me procedurat e brendshme të bashkive. Është e vështirë të bëhet një kategorizim i bashkive (bashkie madhe, mesme apo e vogël) që nuk kanë rishikuar këto procedura. Lidhur me pjesën e buxhetit të raportuar, buxheti mesatar i raportuar është 44,396,326. Gjithsesi, vlen të theksohet se afër 70% e bashkive raportojnë 0 lekë për këtë nënobjektiv.

Lidhur me riskun, pjesa më e madhe e bashkive (59%) perceptojnë një risk të mesëm, krahasimisht me 34% të bashkive që raportojnë një risk të ulët apo 6% që raportojnë një risk të lartë. Ndër problemet kryesore që lidhen me implementimin e aktiviteteve të këtij nënobjektivit, bashkitë raportojnë financat e kufizuara, kapacitetet e burimeve njerëzore të kufizuara dhe situata e COVID.

**Grafiku 10:** Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.1



**Lidhur me aktivitetin D1.2** "Përgatitjen e një programi për rritjen e mundësisit të aksesit efektiv të qytetarëve në vendimmarrjen vendore dhe aktet normative vendore përmes botimit proaktiv dhe përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit", bashkitë raportojnë përshtatjet e bëra


për shkak të situatës së pandemisë, ku bashkitë kanë mbajtur mbledhjet online. Për shembull, raportohet se mbledhjet e Këshillit Bashkiak përveç se janë mbajtur online, janë transmetuar live në rrjetet sociale me qëllim që publiku i gjerë të jetë pjesë. Gjithashtu, bashkitë raportojnë mbi Programin e Transparencës, përmes të cilit rregullohet e drejta e qytetarëve për t'u informuar dhe për t'u ankuar, kërkuar informacion mbi shpërndarjen e buxhetit, procedurat e prokurimit, shërbimet që ofrohen nga Bashkia. Një pjesë tjetër e bashkive (p.sh Bashkia Patos, Gramsh, etj.) vë theksin tek roli i Koordinatorit të së Drejtës për Informim dhe Koordinatorit të Konsultimit Publik me qëllim që kalendari i dëgjësive publike.

Bashkitë raportojnë miratimin e Programit të Transparencës, e cila kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në transparencën dhe llogaridhënien vendore, duke u kombinuar me bërjen publike të kalendarit të dëgjësive publike ashtu edhe transmetimit live të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Bashkitë citojnë faqen “vendime.al” si një faqe e cila i jep akses qytetarëve apo çdo aktori vendor të shohë vendimet e bashkisë të zbardhura në kohë reale. Gjithsesi, para miratimit të çdo projektakti, pjesa më e madhe e bashkive raportojnë që mbajnë dëgjësia publike me qytetarët dhe grupet e interesit para marrjes së vendimeve të rëndësishme vendore.

Lidhur me buxhetimin për këtë zë, vetëm 10 bashki nga 42 raportojnë të kenë alokuar një zë specific në buxhet për rritjen e mundësimin të aksesit efektiv të qytetarëve në vendimmarrjen vendore dhe aktet normative vendore përmes botimit proaktiv dhe përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Në bashkitë raportuese me një zë pozitiv në buxhet vihet re që mesatarisht shuma e alokuar është rreth 800,000 lekë.

Së fundmi, lidhur me këtë aktivitet, mbi komentet të tjera, bashkitë më së shumti citojnë pjesën e përshtatjes ndaj COVID-19 dhe kalimit më së shumti online të komunikimit. Një pjesë e bashkive raportojnë mbi nevojën për të shtrire komunikimin gjithëpërfshirës me qytetarët veçanërisht në njësitë administrative të largëta. Nëse komunikimi online është relativisht më i volitshëm për bashkinë qendër, për njësitë administrative larg bashkisë, komunikimi ka sfidat e veta.

**Grafiku 11: Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.2**



Duke kaluar tek aktiviteti D1.3 "Mbështetjen e qeverisjes vendore për përdorimin e platformave të informacionit publik", sikurse nënobjektivat më lart, bashkitë raportojnë të kenë përdorur faqet zyrtare të tyre të internetit, rrjetet sociale, publikimet dhe afishimet pranë këndit të publikimeve




pranë ambienteve të bashkisë dhe njësive administrative, si edhe njoftime dhe informacione nëpërmjet administrative të Njësive Administrative.

Përgjithësisht, ky aktivitet konsiderohet si i plotësuar nga bashkitë raportuese, e ndërsa theksi vendoset tek platformat online, kjo edhe për shkak të situatës së pandemisë.


**Lidhur me aktivitet D1.4**, i cili përbëhet nga masa a) "Konsultime publike për buxhetin afatmesëm dhe vjetor", b) "Konsultime publike me qytetarët, tatimpaguesit familjarë dhe organizatat e biznesit për taksat e tarifave vendore" dhe c) "Botimi i udhërrëfyesve praktikë për taksat dhe buxhetet vendore për qytetarët dhe bizneset". Në tërësi, për dy masat e para, raportimet janë të ngjashme dhe shfaqin të njëjtën progres. Më konkretisht, rreth 60% e bashkive raportojnë se konsultimet koordinohen nga koordinatori i konsultimit publik në bashki, i cili përpilon Regjistrin Elektronik të dëgjësive publike. Ndërkohë, të gjitha bashkitë raportojnë se gjatë vitit 2020 konsultimet janë bërë duke respektuar kufizimet e COVID-19, apo online nëpërmjet platformave të ndryshme. Konsultimet kanë përfshirë Programin Buxhetor Afatmesëm, Paketën Fiskale, Projekt Buxhetin, etj. Ndër problemet e renditura patjetër në kushtet e pandemisë përmenden pamundësia e përfshirjes së një numri më të madh qytetarësh e grupesh interesi në takimet fizike, gjithsesi kjo është munduar të rikuperohet nëpërmjet takimeve online të shfaqura edhe për publikun. Gjithashtu, si detyrim i këshillave për këtë proces, Bashkitë kanë miratuar rregulloret e konsultimit, udhëzimet dhe instrumentat përkatës.

Përsa i përket kostos për këtë aktivitet, bashkitë raportojnë të kenë pasur një kosto zero. Ndërsa, perceptimi mbi riskun mbi masën a) dhe b), meqenëse janë afërsisht të njëjta, duket se qëndron njëloj si aktivitetet e tjera. Më specifikisht, pjesa më e madhe e bashkive raportojnë një risk të mesëm, duke konsideruar kufizimet e dëgjësive publike në kushte fizike si problem, më pas si risk të ulët dhe shumë pak bashki si risk të lartë (Figura 3).

**Grafiku 12:** Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.4 (masat a dhe b)



Së fundmi, mbi masën D1.4c "Botimi i udhërrëfyesve praktikë për taksat dhe buxhetet vendore për qytetarët dhe bizneset", raportohet nga pjesa më e madhe e bashkive se nuk është hartuar një udhërrëfyes specifik për taksat dhe buxhetin vendor, por ky i fundit është pjesa e paketës fiskale dhe buxhetit të botuar.

**Grafiku 13:** Perceptimi i riskut për aktivitetin D1.4 (masa c)

Përsa i përket treguesit të performancës të lidhur drejtpërdrejt me këtë nënobjektiv, Plani i Veprimit të SKNDQV parashikon “Numrin e bashkive që botojnë vendimet e këshillit online në mënyrë të plotë”. Kjo matet me vendimet e publikuara tek vendime.al, një faqe në të cilën botohen të gjitha vendimet e këshillit bashkiak të 61 bashkive. Konstatimet nga faqja vendime.al rezultojnë se të gjitha bashkitë botojnë, faqe e cila lidhet direkt me faqet personale të bashkive, por gjithsesi vërehet se ka një vonesë kohore në botimin e disa prej vendimeve të këshillit bashkiak.

## D2. Integrimi evropian dhe qeverisja vendore

Lidhur me nënobjektivin D2, një nënobjektiv për të cilën fusha e përgjegjësisë është e Ministrisë së Brendshme/AMVV, MEPJ, MFE dhe Shoqatat e Qarqeve dhe Bashkive. Për të gjitha aktivitetet parashikohen për periudhën 2020-2022, përveç D2.7 që parashikohet për 2020-2021. Objektivi D2 “Integrimi evropian dhe qeverisja vendore” përfshin aktivitetet më poshtë:

- D2.1 Forcimi i kapaciteteve të NJVV në kuadrin e projekteve të financuara nga fondet e BE-së
- D2.2 Forcimi i kapaciteteve të Njësive të Integritimit Evropian në të gjitha bashkitë
- D2.3 Vlerësimi i performancës së bashkive në kuadër të procesit të Integritimit Evropian
- D2.4 Forcimi i bashkëpunimit midis NJVV-ve në kuadrin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkufitar
- D2.5 Fushatë informacioni mbi procesin e integritimit dhe BE-në në nivel vendor
- D2.6 Mbështetje e NJVV-ve me synim rritjen e aksesit në fondet e BE-së
- D2.7 Ngritja e Fondit Kombëtar për nivelin Vendor lidhur me projektet e BE-së

**Lidhur me aktivitetin D2.1-D2.3**, MB/AMVV është asistuar nga projekti “Bashkitë për në Evropën”, i financuar nga Bashkimi Evropian për forcimin e kapaciteteve të NJVV për aplikime për fondet e BE-së nëpërmjet Njësive të Integritimit Evropian, ashtu edhe forcimit të kapaciteteve të këtyre njësive në të gjithë bashkitë, dhe rritjes së performancës së tyre në kuadër të procesit të Integritimit Evropian. Në 2020, së pari, janë bërë përpjekje nga AMVV që të gjithë bashkitë të kenë në organigramën e tyre njësinë e Integritimit Evropian (përpjekja e fundit ishte bashkia Vorë). Gjithsesi, duhet përmendur që

edhe pse në organigramë të gjitha bashkitë mund të jenë të pajisura me Njësi Integritetit, jo të gjitha janë në përputhje me VKM e ngritjes së këtyre njësive. Ndërsa, lidhur me performancën, raportohet nga AMVV se ky proces nuk është ndërmarrë ende për shkak të faktorëve të ndryshme si brenda në AMVV (ristrukturimi i saj), ashtu edhe situatës së pandemisë në të gjitha bashkitë.

Lidhur me aktivitetin D2.4, shoqatat raporton se ka gjatë vitit 2020 ka pasur ndërveprim mes bashkive kufitare me ndihma ushqimore dhe financiare për përballimin e situatës se krijuar nga tërmeti. Gjithashtu, kjo është shoqëruar me një ndërgjegjësim të lartë të ardhur nga bashkitë fqinje të rajonit. Lidhur me projektet IPA, bashkitë kanë patur një bashkëpunim kufitar, si bashkia Elbasan, Dibër, Korçë, Durrës, Shkodër, Kukës, e të tjera. Bashkëpunime mes bashkive kanë ndodhur dhe në drejtim të menaxhimit të mbetjeve si p.sh.. bashkitë e qarkut Lezhë, Fier dhe Dibër.

Gjithashtu, gjatë vitit 2020, shoqata ka asistuar bashkitë me asistencë teknike për ngritje kapacitetesh në përballimin e situatës se emergjencave nga tërmeti dhe pandemia. Tre eksperte të ardhur nga Kroacia dhe Turqia janë vendosur në bashkitë Krujë, Kurbin dhe Tiranë pas tërmetit. Së fundmi, janë zhvilluar trajnime të kapaciteteve vendore në përballimin e emergjencave gjatë pandemisë.

Lidhur me aktivitetin D2.5 “Fushatë informacioni mbi procesin e integritetit dhe BE-në në nivel vendor”, ky aktivitet konsiderohet i realizuar nga MB/AMVV, e cila është asistuar nga projekti i Delegacionit Evropian “Bashkitë për në Evropë”, me fushatë sensibilizuese dhe informative mbi procesin e integritetit në nivel vendor në të gjitha bashkitë e vendit. Gjithashtu, SHAV raporton se të tilla aktivitete lidhur me procesin e integritetit nga ana e bashkive kanë ndodhur edhe në bashkitë Klos, Mirditë dhe Mat në kuadër të projekteve të ngjashme si “ADRIONET - Adriatic-Ionian Network of Authentic Villages”.

**Lidhur me nënobjektivin D3** “Fuqizimi i strukturave komunitare në nivel vendor (Komisionet Qytetare, Kryetarët e fshatrave, Ndërlidhësit Qytetarë)”, përfshin në vetvete dy masat si më poshtë:

- a) D3.1 Forcimi i kapaciteteve të ndërlidhësve me qytetarin në strukturat komunitare
- b) D3.2 Përgatitja e një udhëzuesi mbi funksionimin e strukturave komunitare

Lidhur me masën a, raportohet se për shkak të situatës së tërmetit dhe pandemisë, fuqizimi i strukturave komunitare ka pasur avantazhet dhe disavantazhet e veta. Më konkretisht, gjatë situatave të sipërcituara, NJVV kanë punuar me komunitetin nëpërmjet pikave të kontaktit. Gjithsesi, puna për përgatitjen e një udhëzuesi mbi funksionin e strukturave komunitare, duke qenë se puna ka qenë tërësisht në terren, është lënë për një periudhë të mëvonshme. Aktualisht është miratuar vetëm rregullorja e Këshillit për Zgjedhjen e Ndërlidhësve Komunitar.

#### **D4. Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore**

Lufta kundër korrupsionit mbetet një ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare, e cila reflektohet jo vetëm në Planin e Veprimit të SKNDQV, por edhe atë të Antikorrupsionit. Më konkretisht, sipas Planit të Veprimit të SKNDQV 2020-2022, nënobjektivi D4 fokusohet tek adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore, i cili përbëhet nga aktivitetet D4.1 “Përcaktimi i metodologjisë dhe hartimi i drafteve të Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes”, D4.2 “Hartimi i Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në bashkitë pilot dhe konsultimi me grupet e interesit”, D4.3 “Informimi dhe ngritja e kapaciteteve të bashkive të

reja mbi përdorimin e instrumenteve të hartuara në kuadër të politikave anti-korrupsion dhe marrja në dorëzim nga autoritetet përgjegjëse të qeverisë qendrore”, D4.4 “Takime informuese për hartimin e Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në të gjitha bashkitë e vendit (në vijim të 6 bashkive pilot)”, D4.5 “Hartimi i Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes dhe konsultimi me grupet e interesit” dhe D4.6 “Inkurajimi i bashkive të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore AK, në përputhje me Strategjinë AK dhe inkurajimi i bashkive të tjera”.

Në tërësi, ky aktivitet përqendrohet në forcimin e imazhit të zyrtarit publik në nivel vendor, bazuar tek transparenca dhe përgjegjësia, për rritjen e përfshirjes së shoqërisë civile në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e iniciativave të ndryshme me interes dhe shqetësim lokal dhe rritjen e adoptimit të sistemeve që dekurajojnë praktikat korruptive dhe promovojnë transparencën (lehtësimin e procedurave të ofrimit të shërbimeve dhe krijimin e Zyrave me Një Ndalesë, bërja publike e dokumenteve, konsultimi i politikave dhe përparësitë e zhvillimit, përmirësimi financiar, menaxhimi dhe raportimi dhe krijimi i ofrimit të shërbimeve dhe mekanizmave të monitorimit).

Lidhur me aktivitetin e parë, D4.1, Ministria e Brendshme dhe AMVV, si institucionet koordinuese me NJVV, janë përgjegjëset kryesore për zbatimin e këtij aktiviteti përgjatë vitit 2020-2021. Ministria e Drejtësisë dhe NJVV janë kontribuuesit kryesorë së bashku me Partnerët e Zhvillimit. Më konkretisht, projekti STAR2, një projekt ku Qeveria Shqiptare është bashkëfinancuese, ka hartuar metodologjinë për hartimin e drafteve të Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes. Kjo ka përfshirë (a) përgatitjen e metodologjisë së Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes, ashtu edhe (b) hartimin e drafteve, proceset e konsultimit, rishikimi e finalizimi i tyre.

Këto dy masa të sipërpërmendur, edhe pse parashikohen të bëhen gjatë dy viteve, janë realizuar në masën 100%. Metodologjia e hartimit të Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes është një metodologji e miratuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila është në përputhje edhe me Metodologjinë për institucionet qendrore.

Së dyti, lidhur me aktivitetin D4.2, **Hartimi i Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në bashkitë pilot dhe konsultimi me grupet e interesit**, raportohet nga Ministria e Brendshme/AMVV se bazuar tek metodologjia e miratuar, në asistencën e projektit STAR2, janë përgatitur planet vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes për 6 bashkitë pilote. Më konkretisht, bashkitë pilote, të cilat janë ofruar në mënyrë vullnetare për hartimin e këtyre planeve, janë bashkitë Durrës, Elbasan, Gjirokastër, Patos, Mat dhe Mallakastër.

Pas themelimit të Grupit të Punës për Integritetin (GNP) në secilën prej 6 bashkive të zgjedhura, me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë, u zhvilluan 6 sesione (takime) tematike në secilën bashki. Këto sesione kishin për qëllim identifikimin e të gjitha proceseve të zonave të veprimtarisë së bashkisë vulnerabël nga korrupsioni, shkelje e integritetit, sjellje joetike dhe joprofessionale dhe parregullsi të tjera. Rreziqet dhe masat e integritetit u identifikuan përmes një qasje nga poshtë lart, duke përfshirë drejtpërdrejt stafin e bashkisë në analizën dhe vlerësimin e procesit, duke siguruar plane të integritetit të personalizuara.

Pavarësisht aspekteve të veçanta nëpër bashki, një plan integriteti përfshin fushat e (i) menaxhimit financiar, (ii) burimeve njerëzore, (iii) kontrollit, auditit dhe mekanizmave kundër korrupsionit, (iv) shërbimeve publike, (v) administrimit dhe menaxhimit të pronave, (vi) planifikimit të territorit dhe (vii)

arkivimi, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit të dokumenteve elektronik.



**Ndërsa, lidhur me aktivitetin D4.3** “Informimi dhe ngritja e kapaciteteve të bashkive të reja mbi përdorimin e instrumenteve të hartuara në kuadër të politikave anti-korrupsion dhe marrja në dorëzim nga autoritetet përgjegjëse të qeverisë qendrore”, D4.4 “Takime informuese për hartimin e Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në të gjitha bashkitë e vendit (në vijim të 6 bashkive pilot)” dhe D4.5 “Hartimi i Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes dhe konsultimi me grupet e interesit”, raportohet se të gjitha këto objektiva janë përmbushur për vitin 2020, duke qenë se kanë qenë procese integrale në hartimin dhe miratimin e planeve të integritetit për 6 bashkitë pilote.

Në të gjitha rastet, për përgatitjen e planeve vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes janë mbajtur takime teknike konsultative dhe është ofruar ekspertizë teknike për finalizimin e modelit të personalizuar për secilën bashki.

**Lidhur me D4.6** “Inkurajimi i bashkive të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore AK, në përputhje me Strategjinë AK dhe inkurajimi i bashkive të tjera”, duhet theksuar se çdo plan integriteti shoqërohet me masa për secilën bashki. Kështu, çdo masë kostohehet dhe përkthehet në buxhet specifik që bashkia respektive alokon për luftën anti-korrupsion. Kështu, të 6 bashkitë me plane integriteti janë inkurajuar për përcaktimin e një buxheti specifik për implementimin e politikave vendore në luftën anti-korrupsion, e cila është në përputhje me SKNDQV dhe Strategjinë Anti-Korrupsion.

Lidhur me bashkitë e tjera, procesi do të vijojë në vitin 2021, atëherë kur të fillojë edhe hartimi i planeve të reja të integritetit për bashkitë pasuese.

**Tabela 3:** Realizimi i Nënobjektivi/Aktiviteti për Objektivin Specifik D

Nënobjektivi/Aktiviteti	Shkalla e realizimit
D4. Adoptimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore	100%
D4.1 Përcaktimi i metodologjisë dhe hartimi i drafteve të Vlerësimit të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit Standard të Sjelljes	100%

D4.2 Hartimi i Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në bashkitë pilot dhe konsultimi me grupet e interesit	100%
D4.3 Informimi dhe ngritja e kapaciteteve të bashkive të reja mbi përdorimin e instrumenteve të hartuara në kuadër të politikave anti-korrupsion dhe marrja në dorëzim nga autoritetet përgjegjëse të qeverisë qendrore	100%
D4.4 Takime informuese për hartimin e Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes në të gjitha bashkitë e vendit (në vijim të 6 bashkive pilot)	100%
D4.5 Hartimi i Planeve Vendore të Rrezikut të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes dhe konsultimi me grupet e interesit	100%
D4.6 Inkurajimi i bashkive të përcaktojnë një buxhet specifik për implementimin e politikave vendore AK, në përputhje me Strategjinë AK dhe inkurajimi i bashkive të tjera	100%

Lidhur me treguesin e performancës që lidhen më këtë nënobjektiv vihet re se ka vetëm një tregues performance i cili mat numrin e planeve të integritetit të hartuara në nivel vendor. Kësisoj, pashaporta shkurt e këtij treguesi është si më poshtë. Raportohet që për vitin 2020 ky numër është 6 e ndërsa në vitin pasues (2021), numri i planeve të integritetit të parashikuara do të jetë 10.

## 5. Vlerësimi i riskut


Lidhur me riskun, në këtë raport janë marrë në konsideratë disa lloje risqesh, të lidhura me institucionin përgjegjës për agjendën e decentralizimit dhe institucionet e tjera. Së pari, me rëndësi është të përmendim situatën e post-tërmetit dhe pandeminë. Situata e post-tërmetit duket se ka prekur më së shumtë nivelin vendor dhe objektivat/nënobjektivat/aktivitetit në përgjegjësinë e NJVV-ve. Ndërsa, pandemia është një situata gjithëpërfshirëse, me ndikim në të dy nivelet qeverisëse, si atë qendror dhe atë vendor.

Përtej këtyre dy risqeve të mirëpranuara nga shumë institucione, ka pasur edhe risqe të tjera që lidhen me ristrukturimin e institucionit përgjegjës për koordinimin me pushtetin vendor. Më konkretisht, ristrukturimi i njëkohshëm i MB-së dhe AMVV-së mendohet të ketë efekte në koordinim me ministritë e linjës dhe agjencitë qendrore, që lidhen me avancimin e planit të veprimit të SKNDQV. Kësisoj, ristrukturimi i MB-së u shoqërua me vonesa në plotësimin e stafit, çka solli edhe vonesa në gjurmimin e monitorimit të zbatimit të planit të veprimit të SKNDQV për vitin 2020. Gjithashtu, ristrukturimi i AMVV me tre sektorë u shoqërua edhe me heqjen e kategorisë inspektor të stafit, gjë e cila ndikoi në uljen e pagës së një pjesë të strukturës. Ky ndryshim me efekt buxhetor mund të ndikojë në një paqëndrueshmëri të stafit në këtë agjenci.

Lidhur me risqet gjatë fazës së monitorimit të planit të veprimit, përtej faktit që plani përfshin koordinim me shumë institucione si të nivelit qendror dhe atij vendor, raportohet se plotësimi i informacionit të kërkuar nga institucionet e ndryshme në nivel qendror dhe vendor si dhe nga ministritë e linjës, që kanë aktivitete specifike në këtë plan veprimi, ka qenë i dobët sidomos për pjesën e vlerësimit të riskut dhe atij buxhetor. Kjo ka bërë që monitorimi i planit të veprimit të mbështetet mbi pjesën përshkruese të raportimit pa patur mundësi të bëjë një vlerësim të plotë të riskut dhe nevojave buxhetore për realizimin e plotë të aktiviteteve deri në fund të vitit 2022 që konsiston me mbylljen e planit të veprimit.


Duke u nisur nga raportimet e bëra nga të gjithë institucionet përgjegjëse për secilën nga masat, dhe duke marrë në konsideratë ato masa të cilat janë realizuar një analizë më e detajuar mbi nivelin e riskut për secilin objektiv paraqitet në vijim. Përsa i përket objektivit A niveli i riskut është raportuar për 33 masa nga 45 që ka në total objektivi A.

**Grafiku 14:** Niveli i riskut sipas masave për secilin nën-objektiv të objektivit A




Lidhur me objektivin B analiza e riskut është raportuar për 8 masa nga 21 që janë në total në këtë objektivi. Në mënyrë më të plotë informacioni jepet në grafikonin 15.

**Grafiku 15:** Niveli i riskut sipas masave për secilin nën-objektiv të objektivit B



Lidhur me Objektivin C niveli i riskut është raportuar për 20 masa nga 68 që ka në total objektivi ky objektiv, në të cilin raportojnë një numër i konsiderueshëm institucionesh.

**Grafiku 16:** Niveli i riskut sipas masave për secilin nën-objektiv të objektivit C



Përsa i përket objektivit D duke qenë se raportimi është në nivel NjVV-je analiza e riskut është bërë për secilën masë në mënyrë të pavarur në pikën 4.4.

## 6. Konkluzione dhe Rekomandime

Nga raporti monitorues i planit të veprimit të SKNDQV, i cili ka një shtrirje 2020-2022, vlen të theksohet që gjatë vitit të parë të implementimit të tij, në të gjithë nën-objektivat ka patur rezultate konkrete dhe rreth 70% e aktiviteteve kanë filluar implementimin e tyre. Edhe pse SKNDQV është një strategji ndërsektoriale dhe në të janë të përfshirë një numër i konsiderueshëm institucionesh theksohet se ecuria e procesit të raportimit është shtrirë në të gjitha institucionet përkatëse. Gjithsesi, vërehet se institucionet përgjegjëse për aktivitetet në planin e veprimit të SKNDQV përgjithësisht kanë raportuar në baza narrative dhe jo mbi masën e realizimit të objektivit/nënobjektivit/aktivitetit.

Raportim i realizimit të aktiviteteve apo masave nga institucionet përgjegjëse është një problematikë e hasur ndjeshëm, e cila e ka bërë të vështirë analizimin dhe vlerësimin sasior të implementimit të planit të veprimit. Gjithashtu, plotësimi i indikatorëve të vlerësimit të planit të veprimit, edhe pse në një nivel të konsiderueshëm, plotësimi nuk ka arritur në 100 % të plotësisht.

Problematikë ngelet përcaktimi i mbulimit buxhetor edhe në nivel aktiviteti, kjo vihet re në raportimin e institucioneve që kanë raportuar shumë pak në këtë drejtim. Mungesa e informacionit të detajuar buxhetor e bën të vështirë analizën e hendekut financiar në kohë, e si rrjedhim edhe më të vështirë për të ndërhyrë në planifikimin buxhetor afatmesëm për secilin institucion në nivel qendror apo vendor.

Lidhur me konkluzionet kryesore nga ky raport monitorimi përmenden:



1. Harmonizimi ligjor konsiderohet si i suksesshëm, kjo edhe për shkak të ndjekjes me Urdhrin e Kryeministrit mbi harmonizimin ligjor dhe përfshirjen në planin analitik dhe rolit të këshillit konsultativ në këtë kuadër;
2. Zyrat me Një Ndalesë shënuan një progres për vitin 2020, dhe nevojën për t'u shtrirë në të gjitha NJVV-të duke ritheksuar edhe prioritetin e Qeverisë Shqiptare në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve;
3. Konsolidim i procesit të PBA ka qenë i qëndrueshëm dhe i kënaqshëm, i cili në mënyrë periodike po unifikohet nga të gjitha NJVV-të;
4. Ende problem varësia dhe gjendja fiskale e disa bashkive e cila është e lidhur edhe me situatën e krijuar nga tërmeti 2019 dhe pandemia 2020;
5. Zbatimi i ndarjes së të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale, për të cilën ka patur një përmirësim në periudhën ekzekutuese;
6. Diskutime konkrete lidhur me Rentën Minerare për të rritur përpjesën që marrin bashkitë nga buxheti i shtetit;
7. Rrjetet e ujitjes dhe kullimit; por gjithsesi nevojë për digat me ujëmbledhës për rëndësinë në bujqësi;
8. Funkcionet të lidhura me sigurinë publike kanë pasur progres, veçanërisht shërbimi i Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimin, por ende në proces projektligji i Policisë Bashkiake;
9. Shërbimet Sociale ecuri e kënaqshme, veçanërisht në kuadër të standardeve të disa shërbimeve specifike, regjistrin elektronik të shërbimeve shoqërore dhe trajnimeve të stafit në nivel vendor mbi përdorimin e platformave të ndryshme;
10. Nevojë koordinimi i MASR dhe MFE mbi mirëmbajtjen e objekteve shkollore për një transfertë specifike;
11. Nevoja për vlerësimin e të gjitha standardeve/protokolleve të shërbimit shëndetësor;
12. Nevoja për të prioritzuar funksionin e zhvillimit vendor;
13. Transferimi i pronave të bashkive ngelet një çështje komplekse;
14. Koncepti i standardit minimal, nevojë për të çuar përpara punën e nisur para pandemisë e cila kërkon një përfshirje ndërinstytucionale.

## 7. Aneks

## Lista e Indikatorëve të plotësuar sipas objektivave

<b>Emërtimi i Indikatorit</b>	<b>Numri i bashkive që ofrojnë shërbime administrative në zyra me një ndalesë</b>		
<b>Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik</b>	<i>Objektivi A: Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore</i>		
<b>Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës</b>	Raporti i monitorimit i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		
<b>Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave</b>	<b>Ministria e Brendshme/Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore</b>		
<b>Shpeshësia e publikimit të të dhënave</b>	Vjetore		
<b>Përshkrim i shkurtër i metodologjisë</b>	<p>Ky tregues mat numrin e bashkive që ofrojnë shërbime administrative, pra që kanë të ngritur Zyrat me Një Ndalesë (One Stop Shops) dhe janë funksionale duke ofruar shërbime tek qytetarët.</p> <p>Indikatorit që paraqet shkallën e ngritjes së zyrave me një ndalesë në njësitë e qeverisjes vendore matet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të bashkive që kanë hapur zyra me një ndalesë në vitin referues me numrin e përgjithshëm të 61 njësive bazë të qeverisjes vendore (bashkive) dhe duke e shumëzuar me 100. Numri i bashkive që kanë hapur zyrat me një ndalesë për vlerësimin e këtij indikatorit merret kumulativ.</p> <p>Formula:</p> $I_{NJmNJ} = \frac{\text{Numri total i Bashkive që kanë hapur zyra me një ndalesë}}{61} * 100$ <p>=59</p>		
<b>Informacion për vlerat bazë</b>	<b>Viti</b>	<b>2019</b>	
	<b>Vlera bazë</b>	66% (40 bashki)	
<b>Informacion për vlerat e synuara</b>	<b>Viti</b>	<b>2020</b>	<b>2022</b>
	Vlera e indikatorit	90% (55 bashki)	100% (61 bashki)

<b>Emërtimi i Indikatorit</b>	<b>Numri i bashkive ku sistemi i arkivimit është funksional</b>		
<b>Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik</b>	<i>Objektivi A: Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore</i>		
<b>Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës</b>	Raporti i monitorimit i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		
<b>Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave</b>	<b>Ministria e Brendshme/Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore</b>		
<b>Shpeshësia e publikimit të të dhënave</b>	Vjetore		
<b>Përshkrim i shkurtër i metodologjisë</b>	<p>Ky tregues mat numrin e bashkive që kanë sistemin e arkivimit të ngritur dhe funksional.</p> <p>Indikatorit që vlerëson shkallën e sistemit të arkivimit matet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të bashkive që kanë sistemin e arkivimit në vitin referues me numrin e përgjithshëm të 61 njësive bazë të qeverisjes vendore (bashkive) dhe duke e shumëzuar me 100. Numri i bashkive që kanë sistemin e arkivimit të ngritur dhe funksional për vlerësimin e këtij indikatorit merret kumulativ.</p> <p>Formula:</p>		

	$I_{saf} = \frac{\text{Numri total i bashkive që kanë sistem arkivimi funksional}}{61} * 100\%$ $= 0\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2019	
	Vlera bazë	0% (0 bashki)	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2022
	Vlera e indikatorit	25% (15 bashki)	49% (30 bashki)

Emërtimi i Indikatorit	<b>Trajnimi i së paku 20% të personelit vendor çdo vit në përputhje me vlerësimin e nevojave për trajnim</b>		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi A: Konsolidimi i kapaciteteve strategjike dhe operacionale të njësive të vetëqeverisjes vendore		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raport vlerësimi nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA)		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	<b>Shkolla Shqiptare e Administratës Publike</b>		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues shpreh numrin e raportuar të të trajnuarve në nivel vendor (bashki) nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) kundrejt numrit total të të punësuarve në nivel vendor për vitin t. Formula: $I_{tra} = \frac{\text{Numri i stafit të trajnuar}}{\text{Numri total i stafit}} * 100\% = \frac{6130}{32213} * 100\% = 19\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2019	
	Vlera bazë	15%	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2022
	Vlera e indikatorit	20%	45%

Emërtimi i Indikatorit	<b>Buxheti i qeverisjes vendore në raport me PBB (%)</b>		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi B: Forcimi i Financave Vendore dhe Autonomisë Fiskale		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit (MFE); Raporti i financave të qeverisjes vendore (MFE)		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat buxhetin e alokuar për qeverisjen vendore në raport me Produktin e Brendshëm Bruto (PBB). Vlerat e treguesve merren në terma nominal për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në %. Formula: $I_b = \frac{\text{Buxheti i qeverisjes vendore}}{\text{Produkti i Brendshëm Bruto}} * 100\% = 3.28\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2020	
	Vlera bazë	3.3%	

Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2022
	Vlera e indikatorit	4%	5%

<b>Emërtimi i Indikatorit</b>	<b>Raporti i të ardhurave të veta vendore në raport me PBB (%)</b>		
<b>Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik</b>	<i>Objektivi B: Forcimi i Financave Vendore dhe Autonomisë Fiskale</i>		
<b>Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës</b>	Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit (MFE); Raporti i financave të qeverisjes vendore (MFE)		
<b>Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave</b>	<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>		
<b>Shpeshtësia e publikimit të të dhënave</b>	Vjetore		
<b>Përshkrim i shkurtër i metodologjisë</b>	Ky tregues mat performancën e qeverisjes vendore në mbledhjen e të ardhurave të veta. Më specifikisht merret vlera e të ardhurave të qeverisjes vendore nga burimet e veta (taksat dhe tarifatat vendore, të ardhurat jotatimore vendore) pa përfshirë taksat e ndara apo transfertat duke i pjestuar me vlerën e Produktin e Brendshëm Bruto (PBB). Vlerat e treguesve merren në terma nominal për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në %.  Formula: $I_{TRv} = \frac{\text{Të ardhurat e veta}}{\text{Produkti i Brendshëm Bruto}} * 100\% = 1.4\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2019	
	Vlera bazë	1.49%	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2020
	Vlera e indikatorit	1.65%	1.75%

<b>Emërtimi i Indikatorit</b>	<b>Raporti i buxhetit diskrecionar vendor në raport me PBB (%)</b>		
<b>Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik</b>	<i>Objektivi B: Forcimi i Financave Vendore dhe Autonomisë Fiskale</i>		
<b>Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës</b>	Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit (MFE); Raporti i financave të qeverisjes vendore (MFE)		
<b>Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave</b>	<b>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</b>		
<b>Shpeshtësia e publikimit të të dhënave</b>	Vjetore		
<b>Përshkrim i shkurtër i metodologjisë</b>	Ky tregues mat burimet financiare të qeverisjes vendore mbi të cilat ajo ka diskrecion vendimmarrës për burimin e financimit (të ardhurat e veta; taksat e ndara dhe transfertat e pakushtëzuara dhe specifike) duke i pjesëtuar me vlerën e Produktin e Brendshëm Bruto (PBB). Vlerat e treguesve merren në terma nominal për të njëjtën periudhë reference. Treguesi shprehet në %.  Formula: $I_{TRv} = \frac{\text{Totali i të ardhurave diskrecionare}}{\text{Produkti i Brendshëm Bruto}} * 100\% = 3.02\%$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2019	
	Vlera bazë	3.1%	

Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2020
	Vlera e indikatorit	3.2%	3.5%

Emërtimi i Indikatorit	<b>Vazhdimësia e furnizimit me ujë</b>		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi C: Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Raporti vjetor i ERRU		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	<b>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</b>		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues, sipas metodologjisë së ERRU, mat orët e furnizimit me ujë në 24 orë, në vitin t Formula: $\text{Orët e furnizimit me ujë në 24 orë në vitin } t = 13.79 \text{ ore/dite}$ <b>Ju lutem plotësoni tek formula më sipër (pjesa me të verdhë) rezultatin për vitin 2020</b>		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2019	
	Vlera bazë	13.2 orë/ditë	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2022
	Vlera e indikatorit	15 orë/ditë	20 orë/ditë

Emërtimi i Indikatorit	<b>Numri i bashkive që botojnë vendimet e këshillit online në mënyrë të plotë (në veçanti buxhetet)</b>		
Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik	Objektivi D: Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor		
Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		
Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave	<b>Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore</b>		
Shpeshtësia e publikimit të të dhënave	Vjetore		
Përshkrim i shkurtër i metodologjisë	Ky tregues mat numrin e bashkive që botojnë vendimet e plota dhe jo të pjesshme të këshillit (p.sh. botimi i buxhetit së bashku me ankesat përkatëse) tek faqja e vendime.al në vitin t. Formula: $\text{Numri i bashkive që botojnë vendimet e plota të Këshillit Bashkiak tek faqja e bashkisë (vendime.al) në vitin } t = 61$		
Informacion për vlerat bazë	Viti	2019	
	Vlera bazë	40	
Informacion për vlerat e synuara	Viti	2020	2022
	Vlera e indikatorit	50	61

Emërtimi i Indikatorit	<b>Numri i planeve të integritetit të hartuara në nivel vendor</b>		
------------------------	--	--	--

<b>Objektivi korrespondues i përgjithshëm ose specifik</b>	<i>Objektivi D: Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel vendor</i>		
<b>Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës</b>	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore		
<b>Institucioni përgjegjës për mbledhjen e të dhënave</b>	<b>Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore</b>		
<b>Shpeshtësia e publikimit të të dhënave</b>	Vjetore		
<b>Përshkrim i shkurtër i metodologjisë</b>	Ky tregues mat numrin e bashkive që kanë hartuar një plan integriteti në vitin t.  Formula: <i>Numri i bashkive që hartojnë plan integriteti në vitin 2020 = 6</i>		
<b>Informacion për vlerat bazë</b>	<b>Viti</b>	<b>2019</b>	
	<b>Vlera bazë</b>	0	
<b>Informacion për vlerat e synuara</b>	<b>Viti</b>	<b>2020</b>	<b>2022</b>
	<b>Vlera e indikatorit</b>	6	10 më shumë



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E BRENDSHME